



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

**Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të
Politikave në Kosovë**

(Sistemi i Planifikimit të Integruar)

2017-2021

Prishtinë, dhjetor 2016

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE.....	3
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	4
HYRJE.....	6
METODOLOGJIA	7
ANALIZA E GJENDJES AKTUALE DHE SFIDAT KRYESORE	8
Nevoja për përmirësimin e sistemit të planifikimit dhe koordinimit	8
Zhvillimet e fundit në sistemin e planifikimit dhe koordinimit në Kosovë	9
Analizë krahasuese me vende të tjera	15
VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....	18
INTERVENIMET KRYESORE TË STRATEGJISË	19
I. Përmirësimi i mëtutjeshëm i kornizës së planifikimit strategjik	19
II. Ndërlidhje më e mirë ndërmjet dokumenteve strategjike dhe burimeve financiare.....	24
III. Integrimi i praktikave dhe proceseve të monitorimit	29
IV. Ngritja e kapaciteteve për planifikim dhe koordinim të politikave	32
MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË	35
Reforma e Administratës Publike	35
Monitorimi dhe raportimi i Strategjisë	36
Shqyrtimi afatmesëm i Strategjisë	38
NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË.....	38
Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve	38
Burimet e financimit të Strategjisë	38
SHTOJCA 1: Plani për Zbatimin e Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave	1

LISTA E SHKURTESAVE

BDMS	Sistemi për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Buxhetit
EA	Asistenca e Jashtme
IE	Integrimi Evropian
KBF	Komisioni Qeveritar për çështje Buxhetore dhe Fiskale
SKQ	Sekretariati Koordinues i Qeverisë
PQ	Programi i Qeverisë
KMPQ	Komisioni për Modernizimin e Planifikimit të Qeverisë
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
ZL	Zyra Ligjore
MIE	Ministria e Integrimit Evropian
MF	Ministria e Financave
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
PKMA	Plani Kombëtar për Miratimin e Acquis
ZKM	Zyra e Kryeministrit
IP	Investime Publike
KIP	Komisioni për Investime Publike
PIP	Programi për Investime Publike
PKZMSA	Plani për Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
GMS	Grupi për Menaxhim Strategjik
KPS	Komisioni për Planifikim Strategjik
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik
GDPS	Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Sistemet ekzistuese të planifikimit të politikave dhe planifikimit financiar në Kosovë, në përgjithësi janë të fragmentuara dhe të shpëputura nga njëri-tjetri. Institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme për faktin se krahas progresit të arritur gjatë dekadës së fundit, gjendja aktuale e proceseve qendrore të planifikimit nuk është sipas standardeve të dëshirueshme. Gjithashtu, duke marr parasysh hapësirën e ngushtuar fiskale dhe situatën ekonomike, si dhe intensifikimin e procesit të integritit evropian, vendosja e një planifikimi më efektivë është më se e domosdoshme.

Duke marr parasysh fazën e hershme të reformave institucionale në Kosovë, vlerësohet se është koha e duhur për të adresuar këto probleme. Pa dyshim se vetëm një proces efektiv i planifikimit nuk ofron siguri të përmirësimit të cilësisë së politikave dhe ofrimit të shërbimeve. Megjithatë, pa ndërmarrjen e këtyre masave perspektiva e arritjes së synimeve afatgjatë kombëtare të Kosovës mund të jetë tepër e kufizuar.

Qeveria ka identifikuar mangësitë kryesore të ciklit të kaluar të reformës së administratës publike¹, në bazë të së cilës është zhvilluar një qasje e re dhe janë identifikuar prioritetet për periudhën e ardhshme afatmesme. Për këtë qëllim, është vendosur një kornizë gjithëpërfshirëse strategjike për RAP, e cila ofron udhëzime thelbësore për përzgjedhjen e prioritetëve të reformës, duke i dhënë kështu asaj mbështetjen dhe përkushtimin më të lartë politik. Duke u bazuar në praktika dhe analiza për mënyrën e qasjes së re në reformat e administratës, është vlerësuar se menaxhimi më efikas i procesit dhe përpjekja për evitimin e barrierave në organizimin dhe zbatimin e reformës si dhe nevoja për t'u fokusuar në rezultate ka kushtëzuar qasjen për ndarjen e fushëveprimit dhe strukturave menaxhuese të saj në tri shtylla të Reformës së Administratës Publike, si:

1. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe legjisllacionit – menaxhimi i reformave në këtë fushë bie drejtpërdrejtë nën përgjegjësinë e Zyrës e Kryeministrit;
2. Shërbimi civil, menaxhimi burimeve njerëzore, ofrimi i shërbimeve publike administrative dhe ri-organizimi dhe llogaridhënia - bie nën përgjegjësinë e MAP;
3. Menaxhimi i Financave Publike – bie nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave.

Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë përbënë njërin nga tre strategjitë kryesore që ndërlidhen me Kornizën Strategjike të Kosovës për Reformën e Administratës Publike, së bashku me Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2014-2020, Strategjinë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2018 dhe Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike. Si e tillë, ajo është pjesë e Shtyllës së I-rë “Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave”, që së bashku me dy shtyllat e lartpërmendura përbëjnë pakon strategjike të Reformës së Administratës Publike dhe ajo është nën përgjegjësinë e Zyrës së Kryeministrit.²

¹ Qeveria në korrik 2014 ka miratuar vlerësimin e Strategjisë 2010-2013. Të gjeturat janë se përkundër progresit të arritur, 12 objektivat dhe 40 masat tejkalojnë kapacitetet për zbatimin e portofolios (kryesisht ZKM, MAP, MF) dhe kapacitetet drejtuese të mekanizmit drejtues nga MAP.

² "Paketa Strategjike për RAP" përbëhet nga tri strategjitë kryesore - "Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2015-2018" ose SPPKP, miratuar më 3 qershor 2015 (Vendimi i Qeverisë nr. 23/04), "Strategjia për Rregullim më të Mirë 2014-2020" miratuar më 23 maj 2014 (Vendimi i Qeverisë nr. 03/189); "Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020", miratuar më 25 shtator 2015 (Vendimi i Qeverisë nr. 04/51) dhe Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike e miratuar më 29 qershor 2016 (Vendimi i Qeverisë Nr. 01/98)

Nëpërmjet zbatimit të kësaj strategjie, Qeveria e Republikës së Kosovës synon që të përmirësoj sistemin e planifikimit, duke evituar fragmentimet dhe dyfishimet ndërmjet proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atyre financiare. Fokusi kryesor i kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit është vënë në përmirësimin e Kornizës së Planifikimit Strategjik – me fokus afatshkurtër në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), e cila tashmë është miratuar dhe me synime afatmesme për strategji sektoriale në të gjithë sektorët. Përveç kësaj, synohet avancimi i mëtejshëm në proceset e planifikimit buxhetor, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), përfshi planin trevjeçarë për arritjen e objektivave dhe synimeve brenda kufijve të shpenzimeve. Gjithashtu, agjenda e integritit evropian përbën një element të rëndësishëm në tërë ciklin e planifikimit të politikave, prandaj duke marr parasysh natyrën specifike të këtij procesi, synohet integrimi dhe harmonizimi me proceset tjera të planifikimit dhe koordinimit strategjik. Këto synime janë shprehur përmes objektivave strategjike si në vijim:

- ✚ **Objektivi Strategjik #1: Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, duke përmirësuar ndërlidhjen e dokumenteve strategjike, përmes koordinimit dhe vendimmarrjes më të mirë;**
- ✚ **Objektivi Strategjik #2: Ndërlidhja më e mirë e kornizës për planifikim strategjik me planifikimin e resurseve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përballueshmërinë financiare dhe zbatimin e planeve strategjike;**
- ✚ **Objektivi Strategjik #3: Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit për të siguruar rezultate më të mira të zbatimit dhe llogaridhënies për përmbushjen e objektivave të vendosura të Qeverisë;**
- ✚ **Objektivi Strategjik #4: Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.**

Baza për një arkitekturë të përmirësuar të planifikimit tashmë ekziston në Kosovë. Prandaj, *sfida nuk qëndron tek krijimi i një sistemi krejtësisht të ri, por në ri-formësimin, harmonizimin dhe lidhjen e proceseve ekzistuese*. Në përgjithësi, kjo strategji (bazuar në të ashtuquajturin Sistemi i Planifikimit të Integruar në Kosovë) nuk propozon ndonjë sistem të ri apo sistem të veçantë të planifikimit. Strategjia nuk është as përpjekje për të bashkuar proceset ekzistuese në një proces të veçantë. Ajo që ofron kjo strategji është një numër i parimeve funksionale dhe strukturave mbështetëse për të siguruar se **planifikimi dhe monitorimi qeveritar si tërësi ndërmerren në mënyrë efikase, të integruar dhe harmonizuar**.

Qeveria e Kosovës është e vetëdijshme për faktin se vendosja e një sistemi të integruar të planifikimit dhe monitorimit nuk mund të arrihet thjeshtë me zgjidhje “të përkohshme”. Zbatimi dhe funksionalizimi i sistemit do të merr kohë dhe përveç përmirësimeve strukturore, përfshinë edhe ndryshime të kulturës së menaxhimit dhe administrimit. Ky proces do të ketë përkrahjen e plotë të nivelit më të lartë të Qeverisë, Kryeministrit dhe Kabinetit të tij. Në këtë aspekt, institucionet e Kosovës mund të nxjerrin mësim të shumta nga përvoja e vendeve të tjera që kanë kaluar përmes procesit të njëjtë kohë më parë. Shumë nga vendet e BE-së të anëtarësuar kohëve të fundit janë ballafaquar me probleme të ngjashme në fazat e hershme të rrugës së tyre të anëtarësimit. Disa vende që kanë vendosur një sistem të integruar, sikurse Shqipëria, Lituania dhe

Sllovenia, paraqesin një model të mirë për Kosovën, nëse marrim parasysh se madhësia dhe përvoja e zhvillimit institucional të këtyre vendeve nuk dallojnë shumë nga Kosova.

Për të arritur këtë dhe në pajtueshmëri me parimet e administratës publike për vendet e Ballkanit Perëndimor të përcaktuara nga OECD/SIGMA në bashkëpunim me Komisionin Evropian³, Kosova ka vendosur kornizën strategjike të ndarë në tri shtylla, e cila është e mbështetur nga korniza institucionale, përkatësisht Këshilli Ministror për Reformën e Administratës Publike. Kjo qasje e re mundëson një fokus të veçantë të secilit që ka përgjegjësi në zbatimin e reformave dhe vendos një kornizë të qartë të monitorimit dhe raportimit.

HYRJE

Reforma e Administratës Publike është prioritet kyç i Qeverisë së Kosovës, reformë e cila është thelbësore për zhvillim ekonomik dhe avancimin e procesit të integritimit evropian, duke përfshirë zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim.

Politikat e Qeverisë së Kosovës lidhur me Reformën e Administratës Publike janë të përfshira në dokumentet qeveritare, të cilat përcaktojnë prioritetet e Qeverisë, sic janë: Programi i Qeverisë 2015-2018, në të cilën Qeveria shpreh zotimin për vazhdimin e reformës dhe thekson prioritetet e mandatit ekzistues qeverisës; Strategjia Kombëtare për Zhvillim që e paraqet nevojën e reformës për të arritur synimet për rritje ekonomike dhe përmirësim të konkurrueshmërisë; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, dhe Programi për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim.

Synimet e strategjisë përcaktohen nga një numër i faktorëve dhe rrethanave, ngase politikat programore të Qeverisë gjatë viteve 2015-2018 si prioritet kryesor kanë vendosur zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimit. Administrata publike efektive dhe kapaciteti administrativ për zhvillim të politikave adekuate është një faktor themelor për një ekonomi, e cila krijon vende të reja të punës dhe rritje të mirëqenies për qytetarët. Politikën strategjike për vënien e administratës në shërbim të zhvillimit synon ta vendos edhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim.

Njëkohësisht, rekomandimet dhe gjetjet e raportit të Qeverisë për zbatimin e Strategjisë së RAP 2010–2013, raporteve vlerësuese të OECD/SIGMA, e sidomos raportit dhe prioritetëve të identifikuar me vlerësimin që është bërë më 2014, theksojnë ekzistencën e tri sfidave kryesore për Qeverinë: ngritja e koherencës së planifikimit strategjik dhe ngritja e nivelit të zbatimit; ngritja e kapaciteteve të ministrive për zhvillimin dhe zbatimin e politikave; dhe fuqizimi i kapaciteteve për transpozimin efektiv të acquis. Po ashtu, është theksuar se përmirësimi i sistemit të zhvillimit dhe koordinimit të politikave kontribuon në koordinim më të mirë të RAP, duke krijuar një kornizë të qartë dhe koherente për zhvillimin e strategjive sektoriale dhe duke ngritur kapacitetet për planifikimin dhe zhvillimin e politikave.

Një faktorë tjetër që ka ndikuar në përcaktimin e synimeve të kësaj strategjie ndërlidhet me parimet e OECD/SIGMA për Administratë Publike dhe rezultatet e procesit të prioritizimit të reformave në administratë të zhvilluar gjatë periudhës kohore korrik-tetor 2014. Përveç nevojës që Administrata e Republikës së Kosovës të ketë një platformë strategjike për përmirësimin e punës së saj, kjo strategji zhvillohet edhe mbi bazën e një konteksti të ri të situatës në Kosovë dhe

³ Parimet e Administratës Publike janë zhvilluar nga OECD/SIGMA në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian me qëllim të përcaktimit të kërkesave të hollësishme për një administratë të mirëfilltë në secilën prej fushave kyçe. Edhe pse kriteret për qeverisje të mirë janë universale, OECD/SIGMA ka zhvilluar parime më specifike për vendet që janë në proces të asociimit me BE-në. Ky dokument është i publikuar në gjuhën shqipe: <http://www.sigmaxweb.org/publications/Principles-Public-Administration-Overview-Alb.pdf>

vendeve tjera të rajonit si rezultat i procesit të zgjerimit të BE-së, dhe procesit të Integritimit Evropian të Kosovës sepse së bashku me sundimin e ligjit dhe qeverisjen ekonomike, Reforma e Administratës Publike është një nga shtyllat e Strategjisë së Zgjerimit të BE-së.

METODOLOGJIA

Metodologjia specifike për shtjellimin e strategjisë ka buruar nga analiza e thukët e faktorëve kyç të suksesit dhe sfidat për përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit të politikave në Kosovë, që janë identifikuar nga anëtarët e grupit punues gjatë punëtorive të përbashkëta për hartimin e strategjisë. Në këtë proces janë përfshirë Zyra e Kryeministrit (Zyra për Planifikim Strategjik, Zyra Ligjore dhe Sekretariati Koordinues i Qeverisë), Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Financave dhe ministri të linjës përkatësisht Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.

Si pjesë e procesit për rrumbullakimin e kornizës strategjike për Reformën e Administratës Publike, Strategjia është miratuar në qershor 2015. Megjithatë, pas një viti të zbatimit, duke marr parasysh vlerësimet e aktorëve të ndryshëm dhe me qëllim të përshtatjes me metodologjinë e gjithmbarshme për monitorimin dhe vlerësimin e kornizës strategjike në takimin e Grupit të Veçantë të Administratës Publike (GVRAP), është vendosur që kjo strategji të rishikohet. Rishikimi i saj është vendosur të bëhet vetëm në nivel të objektivave dhe vendosjes së indikatorëve të performancës, duke përfshirë edhe planin veprimit dhe kostimin përkatës të saj.

Për këtë qëllim, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, si Koordinator i Shtyllës së dytë të Reformës së Administratës Publike, ka krijuar grupin punues për rishikimin e Strategjisë për përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit dhe Strategjisë për Rregullim më të mirë, i cili është udhëhequr nga Drejtori i Zyrës për Planifikim Strategjik të Zyrës së Kryeministrit. Grupi punues është ndarë në dy nëngrupe për secilën strategji, ndërkaq për këtë dokument përfshinë përfaqësuesit e institucioneve të përshkruara më lartë.

Procesi i hartimit të strategjisë është bazuar në vlerësimet e brendshme dhe të jashtme që kanë identifikuar sfidat dhe problemet kryesore në sistemin e planifikimit dhe koordinimit të politikave në Kosovë. Fillimisht është bërë vlerësimi i dokumentit të miratuar vitin e kaluar për të identifikuar ndryshimet e nevojshme në pajtueshmëri me konkluzionet e GVRAP. Në këtë kuadër, me qëllim të përmirësimin të strategjisë me qëllim të sigurimit të zbatimit të saj, gjatë shqyrtimeve në kuadër të grupit punues, është vendosur shkrija apo bashkimi i objektivave të mëparshme, duke rezultuar në katër objektiva nga tetë të versionit të kaluar.

Strategjia gjithashtu është hartuar duke aplikuar metodën krahasuese, fillimisht duke analizuar ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes sistemit të planifikimit dhe koordinimit të politikave në Kosovë, me vendet të tjera. Në bazë të kësaj analize janë identifikuar masat aktuale dhe masat që duhet të ndërmerren për të krijuar një mekanizëm efektiv dhe në harmoni me trendët globalë për të garantuar një planifikim dhe koordinim më të mirë të politikave. Po ashtu, janë marr parasysh raporte dhe vlerësime të ndryshme ndërkombëtare për fushën e zhvillimit dhe koordinimit të politikave, në veçanti raportet e progresit të Komisionit Evropian, Vlerësimet e OECD/SIGMA për Kosovën, indikatorët e Bankës Botërore për efikasitetin e qeverisjes dhe raporte të tjera.

Strategjia e rishikuar për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave është bazuar në punën dhe mbështetjen e ofruar nga projekti i Komisionit Evropian “Mbështetje për Planifikimin Strategjik dhe të Politikave në Kosovë. Rishikimi i Strategjisë është mbështetur nga OECD/SIGMA dhe Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Suedisë (SIDA) që mbështetë Zyrën e Kryeministrit në përmirësimin e zhvillimit dhe koordinimit të politikave. Gjithashtu, përveç shqyrtimeve në kuadër të grupit punues ndërinstitucional, dokumenti i është nënshtruar procesit të konsultimeve të brendshme dhe të jashtme.

ANALIZA E GJENDJES AKTUALE DHE SFIDAT KRYESORE

Nevoja për përmirësimin e sistemit të planifikimit dhe koordinimit

Reforma e Administratës Publike mbetet një prej sfidave kryesore për vendet në zhvillim, me theks të veçantë për vendet aspiruese për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Nga përvojat e mëhershme të proceseve të integritimit është dëshmuar se përgatitjet për integrim në BE duhet të mbështeten nga një sistem i planifikimit, zhvillimit, koordinimit dhe zbatimit të politikave. Ky sistem mundëson një planifikim dhe koordinim më të mirë të aktiviteteve të Qeverisë, duke përfshirë përcaktimin e prioriteteve, zhvillimin e politikave më efikase dhe financiarisht të qëndrueshme. Një sistem i tillë, gjithashtu do të përfshinte konsultime të mirëfillta me të gjithë akterët; dhe po ashtu do të siguroj që politikat zbatohen, komunikohen dhe monitorohen në mënyrë të duhur.

Nga praktikat e kohëve të fundit, si në vendet në zhvillim por edhe në vendet tjera, reformimi i administratës publike është karakterizuar nga dy shtytës kryesorë: e para, trendët dhe zhvillimet e brendshme kanë kërkuar vendosjen e një sistemi sa më të mirë të politikë-bërjes si shtyllë kryesore e një sistemi demokratik transparent dhe efektiv; dhe e dyta, kjo është bërë edhe si përgjigje ndaj kërkesës për përgatitjen e kapaciteteve administrative për të marr përsipër obligimet që dalin nga anëtarësimi në BE.

Në Raportin për Kosovën, të përgatitur nga Komisioni Evropian për vitin 2015 theksohet se baza ligjore dhe strukturat institucionale, përfshirë edhe ato për integrimin evropian, janë kryesisht të vendosura mirë për të siguruar një sistem të qëndrueshëm të politikë-bërjes, por në praktikë planifikimi i politikave është i fragmentuar dhe i mungon prioritizimi në nivel qeveritar. Ndërsa, sipas këtij raporti, strategjitë sektoriale në raste të rralla janë financiarisht të qëndrueshme. Sidoqoftë, ka pasur përmirësime të mëdha në zhvillimin e politikave, ndonëse kapacitetet për hartimin e politikave dhe legjislacionit, duke përfshirë kapacitetin për përafrimin me *acquis*, janë ende të pamjaftueshme. Konsultimet ndër-ministore dhe publike janë të rregulluara mirë, por afatet kohore shpesh kanë qenë të shkurtra për të lejuar për ofrimin e një kontributi efektiv nga shoqëria civile. Ndërsa, sa i përket monitorimit dhe raportimit, fokusi është në zbatimin e aktiviteteve më shumë se sa në ndikimin e politikave qeveritare. Ndërsa, nuk ka raportime që flasin për zbatimin e strategjive sektoriale.

"Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2015-2018" ose SPPKP, e miratuar më 3 qershor 2015 (Vendimi i Qeverisë Nr. 04/23), është një hap përpara në drejtimin për modernizimin e planifikimit të politikave dhe sistemit të koordinimit në Kosovë. Mirëpo zbatimi varet shumë, në mënyrë të veçantë, nga rëndësia që do ti jap vetë ZKM dhe institucionet kryesore qendrore, të cilat kanë rolin e rëndësishëm për përmirësimin e procesit të vendimmarrjes dhe prioritizimit.

Me fillimin e zbatimit të Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2015-2018, fushat ku zbatimi i Strategjisë ka përparuar është e lidhur me përmirësimin e sistemit të vendimmarrjes dhe harmonizimin në mes të planifikimit dhe buxhetimit të politikave. Në kuadër të zbatimit të strategjisë dhe parimeve të SPI, Qeveria ka themeluar edhe Komisionin për Planifikim Strategjik në vitin 2016. Komisioni kryesohet nga Kryeministri dhe përfshinë të gjithë ministrat kryesorë. ZPS ka punuar gjerësisht me Ministrinë e Financave në Deklaratën për Prioritetet Afatmesme për KASH 2017-19. Dokumenti është miratuar dhe tani përfshin në një kornizë të prioriteteve për të udhëhequr planifikimin e buxhetit nëpër ministri. Korniza është po ashtu në përputhje me prioritetet e përcaktuara në SKZH dhe PRE.

Po ashtu, ndërlidhja me dokumentet afat-mesme të zhvillimit të politikave është përmirësuar, por ende nuk është gjithëpërfshirëse. Sekretariati i Koordinues i Qeverisë (SKQ) është përgjegjës për procesin e përgatitjes së Planit Vjetor të Punës dhe ka siguruar bashkëpunimin në mes të zyrave pranë ZKM përmes themelimit të Ekipeve të Rishikimit Teknik për rishikimin e propozimeve nga ministrat e linjës. Sidoqoftë, PVPQ është përgatitur me një qasje nga poshtë-lartë, mirëpo kjo nuk siguron se numri i aktiviteteve të përfshira në plan korrespondon me kapacitetet zbatuese të ministrave. Kjo po ashtu bashkë me mungesën e vlerësimit të ndikimit të politikave në buxhet gjatë fazës përgatitore, rezulton në plane joreale dhe një grumbullim në numrin e strategjive, koncept dokumenteve dhe ligjeve për miratim. Shumica e strategjive sektoriale përfshijnë informata sistematike rreth nevojave të shpenzimeve, por jo gjithmonë janë të përfshira edhe burimet e financimit.

Raportet e ndryshme, të cilat monitorojnë progresin e arritur në reformën e administratës publike që ndërlidhet edhe me zhvillimin dhe koordinimin e politikave, theksojnë se ekzistojnë probleme në koordinimin ndërmjet institucioneve të Qendrës së Qeverisë dhe mungesë e kapaciteteve për planifikimin dhe zbatimin e politikave.

Mirëpo, në përgjithësi mund të thuhet se sistemi i planifikimit të politikave në Kosovë është zhvilluar shumë gjatë dekadës së kaluar, me gjithë mjedisin planifikues i cili ende përbëhet nga korniza të shumta, secila me kalendar individual të ndarë dhe kërkesa të ndryshme për monitorim dhe raportim.

Zhvillimet e fundit në sistemin e planifikimit dhe koordinimit në Kosovë

Raportet që flasin për progresin e zbatimit të Reformës së Administratës Publike të Kosovës (RAP) theksojnë se shkalla e zbatimit të reformave të planifikuara në Strategjinë e parë të RAP (2010-2014) nuk është shumë e kënaqshme. Theksohet se ekzistojnë mangësi të qarta në mekanizmat e koordinimit dhe monitorimit, në përzgjedhjen dhe prioritizimin e aktiviteteve, si dhe financimit të tyre nga Buxheti i Kosovës dhe/ose ndihma e jashtme. Në bazë të analizës së kryer nga mesi i vitit 2014 në dialogun e politikave në kuadër të Grupit të Veçantë për RAP ndërmjet BE-së dhe Kosovës, Qeveria është dakorduar për të adresuar mangësitë me ndihmën e KE-së dhe SIGMA.

Sfidat që duhet të adresohen - Përmirësimi i koordinimit dhe planifikimit të politikave mbetet sfida për Kosovën, edhe pse është i domosdoshëm për Integrimin Evropian. Ekziston nevoja për të arritur harmonizim më të mirë midis politikave dhe buxhetit. Me situatën e shtrënguar fiskale dhe ekonomike, si dhe procesin e integritimit në BE, planifikimi më efektiv dhe realist i politikave po bëhet më kërkues për Kosovën për shkak të miratimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

(MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës (më 1 prill 2016). Për të arritur përmirësimin e sistemit të planifikimit të politikave dhe koordinimit, çështjet e mëposhtme themelore duhet të përmirësohen:

Nevoja për konsolidimin e Kornizës për Planifikim Strategjik - Korniza për planifikimin e politikave në Kosovë përbëhet nga shtatë dokumente kryesore: Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) liston prioritetet strategjike të Kosovës për të siguruar rritjen ekonomike dhe përfshirjen dhe kohezionin social; Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) ofron kornizën për planifikim afatmesëm të integritit evropian; Agjenda për Reformën Evropiane (ARE) dokument për zhvillimin e dialogut të nivelit të lartë politik mes Republikës së Kosovës dhe BE-së që do ta shtyjë përpara zbatimin e MSA-së dhe reformat e tjera fundamentale për aderimin e vendit në BE; Programi për Reformën Ekonomike (PRE) që fokusohet në rritjen e konkurrueshmërisë dhe ofron një kornizë të përbashkët buxhetore; Deklarata e Prioriteteve Afatmesme (DPA), dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) - DPA e Qeverisë rishikohet në baza vjetore para procesit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), i cili ofron perspektivën buxhetore për tri vitet e ardhshme; si dhe Plani Vjetor i Punës së Qeverisë (PVPQ) që reflekton zotimet e Qeverisë nga të gjitha dokumentet strategjike për vitin aktual.

Megjithatë, konsiderohet se procesi i hartimit të politikave të reja nuk është gjithmonë në përputhje të plotë me dokumentet e lartpërmendura dhe përmbajtja e tyre nuk është e harmonizuar tërësisht. Po ashtu, mungon një hierarki apo tipologji e definuar e dokumenteve strategjike për zhvillimin e politikave. Kjo ndikon që mjedisi i planifikimit të politikave ende përbëhet prej kornizave të shumta, secili me kërkesat e veçanta dhe rezulton në dyfishimin, mbi-prioritizimin, dhe rolet / përgjegjësitë e paqarta.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim – Me qëllim të vendosjes së kornizës strategjike kombëtare, Qeveria e Kosovës në fillim të vitit 2016 ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, e cila konsiderohet të jetë mekanizëm kryesor për të konsoliduar procesin strategjik të prioritizimit. SKZH (e miratuar në Janar 2016), mund të shërbejë si një dokument afatgjatë i prioriteteve dhe ndërtimit të konsensusit. Duke e mbajtur fokusin në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, mandati kryesor i SKZH -së është të siguroj që të gjitha prioritetet e politikës kombëtare, përfshirë integrimin në BE, janë reflektuar në mënyrë të përshtatshme. SKZH do të identifikojë treguesit e nivelit të lartë për të monitoruar progresin e Kosovës drejt synimeve/qëllimeve afatmesme dhe afatgjata.

Megjithatë, duke pasur një dokument gjithëpërfshirës të planifikimit strategjik, është e nevojshme të sigurohet zbatimi i saj dhe ndërlidhje me dokumentet tjera strategjike, në veçanti dokumentet financiare. Pra, është me rëndësi të vendoset një qasje koherente që ndërlidh synimet afatgjata me një strategji afatmesme, përmes së cilës strategjitë horizontale dhe sektoriale informojnë procesin e planifikimit buxhetor, përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Ekzistenca e një dokumenti të tillë gjithëpërfshirës nuk siguron zbatimin e synimeve të deklaruara pa një sistem të mirëfilltë të prioritizimit dhe njëkohësisht harmonizim dhe integrim ndërmjet proceseve të ndryshme planifikuese.

Konsolidimi i kornizës strategjike sektoriale nën drejtimin e SKZH/ PRE / PKZMSA - PRE dhe PKZMSA, nën ombrellën e SKZH, janë dokumentet të cilat duhet të udhëheqin prioritizimin e planifikimit sektorial. Në mënyrë ideale, zbatimi i prioriteteve të SKZH/PRE/ PKZMSA duhet të jetë prioritet i lartë në strategjitë sektoriale, të cilat pastaj do të operacionalizohen nëpërmjet KASH, buxhetimit vjetor dhe PVPQ.

Në fund të vitit 2015, ka pasur 67 plane strategjike në fuqi, që është një numër shumë i lartë. Edhe pse, vitin e kaluar ka pasur një rënie të lehtë të strategjive sektoriale të “grumbulluara” për miratim në krahasim me vitin 2014. Për vitin 2016, janë planifikuar të miratohen 41 dokumente strategjike, ndërsa bazuar në Raportin e SIGMA 2015, rekomandohet që vetëm strategjitë sektoriale të vendosen në planin vjetor të dokumenteve strategjike në mënyrë që këto shifra të dalin sa më reale.

Me këtë numër të madh të dokumenteve strategjike, ekziston një prirje e lartë e fragmentimit, mospërputhshmërisë, dhe presion i qartë nga poshtë lartë që rezulton në plane jo reale të cilat nuk janë priorizuar. Termi “sektor” dhe “strategji” përdoren për nivele të ndryshme. Shpesh, sektori barazohet me një ministri ose agjenci qendrore, në raste të tjera përdoret për të përshkruar nën-sektorin ose edhe fushën e programit në kuadër të një ministrie (p.sh. Strategjia Sektoriale për Pylltari, Industri). Nivele dhe lloje të ndryshme të prioriteteve nuk janë të përkufizuara në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme, ndërsa në shumicën e rasteve mungojnë tregues dhe caqe të sakta. Strategjitë sektoriale vështirë se mund të shfrytëzohen si plane strategjike ose të monitorohen në formë të duhur.

Sipas raportit vlerësues të OECD/SIGMA, konsolidimi i sistemit të planifikimit strategjik mbetet sfidë. ZPS është përgjegjëse për koordinimin e procesit të planifikimit strategjik, megjithatë në mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme nuk ka pasur mundësi që në vazhdimësi të ofroj udhëzimet e nevojshme dhe të kryej kontrollin e cilësisë së strategjive sektoriale. Raporti vlerëson së në raste të shumta ministrinë zhvillojnë strategjitë sektoriale, pa i ndjekur procedurat dhe përmbajtjen standarde të përcaktuara me udhëzimet përkatëse. ZPS është përgjegjëse të sigurojë se një strategji e propozuar nuk është në kundërshtim ose nuk dyfishon ndonjë strategji ekzistuese apo të propozuar nga ministri të tjera. Megjithatë, disa nga strategjitë e miratuara mbulojnë fusha të ngjashme, duke krijuar mundësinë për konflikte dhe dyfishime.⁴

Si rrjedhojë, konsolidimi dhe përmirësimi i cilësisë së dokumenteve strategjike sektoriale mund të jetë hapi i parë drejt përmirësimit të planifikimit sektorial dhe kështu edhe kornizës për planifikim të Qeverisë.

Agjenda evropiane – Procesi i integrimit Evropian i Republikës së Kosovës ka shënuar një dinamikë të theksuar në vitet e fundit. Kosova ka negociuar MSA-në dhe është në prag të përmbylljes së procesit të liberalizimit të vizave. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ka hyrë në fuqi më 01 prill 2016 dhe zbatimi i MSA-së tani është prioritet strategjik dhe forcë shtytëse e vizionit kombëtar dhe synimeve të politikave që mbulojnë SKZH-në dhe strategjitë sektoriale. Ky proces do të ndikojë në çdo sektor dhe identifikojë zotime të hollësishme nga shumica e ministrive. Për këtë qëllim kërkohet përpjekje e përbashkët nga Ministria e Integrimit Evropian, ZKM/ZPS dhe Ministria e Financave për të ofruar plan të hollësishëm dhe metodologji mbi rolin përkatës të Integrimit Evropian në SKZH dhe KASH dhe mekanizmat të integrimit të komponentëve të ndryshëm të saj në proceset e përgjithshme të SPI-së.

Planifikimi i procesit të integrimit evropian është konsoliduar edhe më tutje gjatë vitit 2016, me ç’rast MIE ka përgatitur Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA). Gjithashtu, gjatë 2016 MIE ka vendosur sistemin e ri të monitorimit kuantitativ dhe kualitativ të zbatimit të Programit, dhe gjatë vitit janë përgatitur raportet e rregullta tremujore mbi zbatimin e tij.

⁴ Raporti i monitorimit të Parimeve të Administratës Publike për Kosovën. Maj 2016:
<http://www.sigmaxweb.org/publications/Monitoring-Report-2016-Kosovo.pdf>

Ministria e Integritit Evropian është përgjegjëse për koordinimin e çështjeve që ndërlidhen me IE, duke siguruar që politikat e propozuara janë në linjë me prioritetet e procesit të aderimit në BE. MIE ka udhëhequr procesin e përgatitjes së PKZMSA-së, si dhe është përgjegjëse për koordinimin, raportimin dhe monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të ndërlidhura me IE. Mirëpo, gjatë procesit është vërejtur se ka nevojë për koordinim më të afërt me ministrinë e linjës, kryesisht në sigurimin e zbatimit të duhur dhe me kohë të aktiviteteve të planifikuara.

PKZMSA është hartuar për herë të parë gjatë vitit 2015 dhe është miratuar nga Qeveria në dhjetor 2015. Përkundër përpjekjeve për koordinim mes institucioneve të qendrës së qeverisë (MIE – ZKM – MF), gjatë hartimit të tij ka munguar një proces i standardizuar i koordinimit (në aspektin e procesit dhe afateve kohore). Kjo ka rezultuar në dy mangësi kryesore. Së pari, ka hapësirë për harmonizim më të mirë me PVPQ-në. Së dyti, duhet përmirësuar buxheti i masave afatshkurtra. Korniza institucionale e planifikimit të Integritit Evropian tashmë është e vendosur. Strukturat institucionale për menaxhimin e agjendës evropiane janë themeluar dhe reflekton përvojat më të mira rajonale. Këshilli Ministror për Integritim Evropian është trup më i lartë vendimmarrës, nën udhëheqjen e Kryeministrit, i cili shqyrton përmbushjen e reformave të parapara në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit. Komiteti Punues dhe Komisionet Ekzekutive asistojnë Këshillin në përmbushjen e mandatit të tij dhe janë përgjegjës për monitorim teknik të agjendës evropiane. Strukturat e integritit evropian kanë shqyrtuar rregullisht progresin dhe sfidat që dalin nga procesi i integritit gjatë vitit 2016.

Në maj 2016, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komisioni Evropian kanë lansuar Agjendën për Reforma Evropiane (përfshirë një Plan Veprimi afatshkurtër, për zbatim deri në fund të vitit 2017). ARE është finalizuar në tetor 2016, e më pas është miratuar nga Qeveria dhe lansuar zyrtarisht në fillim të nëntorit 2016. ARE do të shërbejë si platformë për identifikimin e prioritetëve kyçe në kuadër të procesit të integritit evropian që do të sigurojnë zbatimin e MSA-së dhe për dialog të nivelit të rregullt (në baza vjetore) të nivelit të lartë politik Kosovë – BE, në këtë drejtim. Përveç dialogut politik, zbatimi i saj në nivel të politikave/sectorëve do të monitorohet rregullisht përmes kornizës së përbashkët institucionale të themeluar me MSA, dhe do të rishikohet çdo fund vit. ARE është në harmoni me PKZMSA, SKZH dhe PRE.

Me qëllim të përmirësimit të aspekteve kryesore të zbatimit të Agjendës evropiane, gjatë periudhës në vijim, do të shtohen tre aspekte **të reja** në kornizën ekzistuese të planifikimit:

- **Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së** – risi e Programit do të jetë kapitulli *“Deklarata e prioritetëve afatmesme të integritit evropiane për financim nga KASH”*. Në këtë kuadër, MIE do të identifikojë dhe do të përshkruajë prioritetet kyçe afatmesme të cilat duhet të financohen nga buxheti i shtetit.
- **Zbatimi i Agjendës Evropiane të Reformave** – zbatimi i prioritetëve kyçe do të kontribuojnë në zbatimin e kënaqshëm të MSA-së dhe do të sjellë Kosovën më afër aplikimit për statusin e vendit kandidat, në përputhje me Programin e Qeverisë.
- **Dialogu dhe strukturat e MSA-së** – që nga fillimi i vitit 2017 procesi i integritit evropian do të shënojë një momentum të ri me inaugurimin e strukturave formale të stabilizim-asociimit që do të mbikëqyrin zbatimin e MSA-së dhe do të marrin vendimet kyçe rreth procesit të integritit në BE. Këshilli, Komiteti dhe Nënkomitetet e Grupet e

Veçanta të Stabilizim-Asociimit do të jenë në përputhje të plotë me strukturat përkatëse të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor në këtë proces.

Planifikimi buxhetor – Në Kosovë, funksionet kryesore të qendrës së qeverisë janë të vendosura mirë, por koordinimi i përmbajtjes së propozimeve të politikave për vendim në Qeveri ende nuk bëhet në mënyrën e duhur. Sidoqoftë, një përmirësim që nga vlerësimi i fundit i SIGMA-së është se shumica e strategjive sektoriale të shqyrtuara përmbajnë informacion në lidhje me nevojat për shpenzime. Po ashtu se fundmi KASH 2017-2019 në vete përmban 12 sektorë të cilat janë në harmoni me SKZH. Secili prej këtyre sektorëve kanë të identifikuar objektivat kryesore, institucionet që përbëjnë sektorin dhe trendët e financimit 2015- 2016 dhe vlerësimet për financim për vitet 2017-2019.

Ministria e Financave ka përgjegjësinë e përgjithshme për mbikëqyrjen e koordinimit të planifikimit të burimeve. Në Maj 2015, Qeveria ka miratuar një udhëzim administrativ për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor (VNB), i cili zëvendësoi udhëzimet mëparshme kontradiktore. Gjatë procesit të Vlerëimit të VNB, MF, fokusohet nëse buxheti është në dispozicion apo jo për mbulimin e politikës së propozuar. Ministria e Financave bën vlerësimin e ndikimit buxhetor të nismave të reja Qeveritare, duke krahasuar dhe analizuar të dhënat e ofruara nga organi propozues me ndarjet buxhetore të parapara me Ligjin e Buxhetit për vitin fiskal si dhe parashikimet në KASH-in aktual.

Duhet të fuqizohet zbatimi në praktikë i metodologjisë së vendosur me UA 03/2015 për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të Nismave të Reja Qeveritare. Organet propozuese duhet ngritur kapacitetet e tyre për vlerësimin e ndikimit buxhetor të nismave të reja qeveritare, edhe pse në këtë fushë ka përmirësim, por ende nuk është i mjaftueshëm. Prioritetet KASH vërtetë nuk pasqyrojnë disa prioritete të rëndësishme kombëtare, siç është integrimi në BE. Edhe pse, dokumentet strategjike të integritimit në BE identifikojnë fushat prioritare dhe prioritetet IPA marrin ato në konsideratë, nuk ka asnjë lidhje të qartë në mes të këtyre dokumenteve dhe të KASH/buxhetit vjetor. Në masë të madhe, detyrimet e IE - janë mjaftë të paqarta dhe jo shumë të ndërlidhura në shumicën e strategjive sektoriale. Të dhënat e performancës dhe treguesit janë përgjithësisht të paqarta dhe janë përdorur vetëm herë pas here për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit.

Megjithatë, roli i KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet planifikimit strategjik dhe buxhetit vjetor zvogëlohet nga të metat në vijim: aktualisht Deklarata e prioriteteve të Qeverisë përcakton shumë prioritete, duke mos përcaktuar saktësisht prioritetet e Qeverisë si dhe kostot e strategjive sektoriale ndonjëherë nuk janë në përputhje me mundësitë reale të buxhetit dhe nuk shërbejnë si bazë për hartimin e KASH-it. Në rastet e mungesës së kostimit të plotë të strategjive nga OB-të pamundësohet përputhja e plotë e kostimit të duhur me KASH dhe devijime ndërmjet kufirit të shpenzimeve të caktuar në KASH, të aprovuar në Prill, dhe kufirit përfundimtar të buxhetit vjetor për Organizatat Buxhetore të aprovuar në Tetor të vitit të njëjtë. Këto dallime janë më të mëdha ndërmjet buxhetit të vitit të dytë të planifikimit në KASH me buxhetin aktual të aprovuar në vitin vijues.

Menaxhimi i ndihmës së jashtme - Koordinimi i ndihmës së jashtme në Kosovë ka vazhduar të konsolidohet edhe më tutje nën udhëheqjen e MIE-së. MIE ka ngritur kapacitetet e brendshme për të koordinuar me efektivitet ndihmën e jashtme. Strukturat ndër-qeveritare janë avancuar dhe është siguruar një efikasitet më i lartë i tyre. Monitorimi dhe raportimi për ndihmën e jashtme vazhdon të

bëhet me anë të bazës së avancuar të të dhënave - Platforma për Menaxhimin e Jashtëm (*Aid Managment Platform*). Po ashtu, MIE ka lansuar edhe platformën e transparencës së IPA-s dhe donacioneve të tjera në Kosovë. MIE dhe MF bashkëpunojnë ngushtë në kuadër të përgatitjes së KASH-it dhe buxhetit vjetor, më ç 'rast MIE dorëzon të dhënat financiare nga perspektiva e ndihmës së jashtme për qëllimet e komplementimit të buxhetit shtetëror.

Sa i përket donatorit më të madh në Kosovë – Bashkimit Evropian apo fondet e IPA-s, MIE ka vazhduar edhe më tutje të merr përsipër pronësinë në programimin e fondeve të BE-së, përmes hartimit të Dokumenteve Planifikuese Sektoriale dhe Dokumenteve të Veprimit. MIE, në bashkëpunim me MPJ dhe MF ka negociuar edhe marrëveshjet respektive financiare.

Korniza institucionale e planifikimit dhe monitorimit të ndihmës së jashtme tashmë është e vendosur. Strukturat institucionale për koordinimin e donatorëve janë të parapara me Rregulloren për Koordinimin e Donatorëve dhe përbëhen prej:

- Forumit të Nivelit të Lartë;
- Grupeve Punuese për Koordinimin e Donatorëve; dhe
- Nën-grupeve për koordinimin e donatorëve.

Një rol të veçantë në kuadër të kornizës institucionale, luajnë edhe takimet e rregullta me udhëheqësit e agjencive zhvillimore nën udhëheqjen e MIE-së, apo EU MS+. EU MS + ka pasur një rol të rëndësishëm në koordinimin e ndihmës së jashtme për veriun e Kosovës.

Një momentum i ri i koordinimit të asistencës së jashtme është shënuar me themelimin e Këshillit Kombëtar për Investime, nën bashkë-kryesimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Integritit. Këshilli ka ushtruar me efektivitet mandatin e tij, duke koordinuar përgatitjen e Listës Prioritare të Projekteve Infrastrukturore, si dhe ka shqyrtuar dhe miratuar Klauzolën e Investimeve.

MIE përgatit në baza vjetore Raportin Vjetor për ndihmën e jashtme, profilin e donatorëve dhe raportet sektoriale të donatorëve. Të dhënat e prodhuara nga MIE dhe të ofruara nga donatorët konfirmojnë harmonizim të lartë të ndihmës së jashtme me prioritetet e Programit të Qeverisë⁵.

Monitorimi dhe Raportimi – Korniza ligjore përcakton sistemin për monitorimin e performancës së Qeverisë, dhe monitorimi i zbatimit të dokumenteve të planifikimit të nivelit qendror bëhet në baza vjetore dhe raportet janë në dispozicion për publikun. Monitorimi i zbatimit të PVPQ-së kërkon nga ministrinë transmetimin e të dhënave tek SKQ në baza tremujore, duke theksuar nivelin e zbatimit të secilit aktivitet, me theks të veçantë nëse janë përmbushur afatet kohore dhe duke dhënë një përmbledhje të problemeve të paraqitura gjatë zbatimit.

Raportet tremujore dhe vjetore fokusohen në produkte, përveç pjesës së raportit vjetor lidhur me objektivat strategjike të Qeverisë që përmban informata mbi rezultatet e arritura. Megjithatë, për shkak të mungesës së treguesve të duhur dhe caqeve të performancës në PVPQ, nuk monitorohet apo vlerësohet në mënyrë sistematike ndikimi i shumicës së aktiviteteve. Seksioni i raportit për ministrinë përkatëse përfshinë përshkrime të hollësishme të zbatimit të aktiviteteve, pa analizuar zbatimin e planit përkatës, dhe se raporti vjetor nuk përmban të dhëna statistikore për numrin dhe përqindjen e zbatimit të aktiviteteve për secilën ministri, si dhe përmbledhje të përgjithshme për arsyet e mos-zbatimit të aktiviteteve. Në përgjithësi, vlerësohet se monitorimi i performancës së

⁵ Shih Raportin Vjetor të Donacioneve 2014. Raporti Vjetor i Donacioneve 2015 ishte në fazën përfundimtare të përgatitjes në kohën e finalizimit të këtij dokumenti.

Qeverisë nuk përfshinë potencialin e plotë të tij si një mekanizëm menaxhues apo mekanizëm llogaridhënës.

Kontributi për raportin vjetor të progresit të Komisionit Evropian shfrytëzohet për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të integritit evropian. Raportimi për arritjet për të cilat Qeveria është zotuar në PKZMSA është i ndarë nga raportimi për PVPQ. Duke qenë se vetëm 58% të aktiviteteve të PKZMSA-së për vitin 2016 janë përfshirë në PVPQ 2016, një monitorim koherent i zotimeve të PKZMSA është i pamundur, së paku për vitin 2016. Përveç kësaj, ministritë janë të ngarkuara me kërkesa të dyfishta të raportimit për çështje që janë të listuara në PVPQ dhe PKZMSA.

Gjithashtu, raportimi i hollësishëm për zbatimin e strategjive sektoriale është i mangët. Edhe pse, ministritë janë të obliguara të monitorojnë zbatimin e strategjive dhe ZPS mund të kërkojë raporte për zbatimin dokumenteve strategjike që ndërlidhen me prioritet e Qeverisë, nuk ka kërkesë të rregullt për hartimin e raporteve të zbatimit dhe dorëzimit të tyre në Qeveri, por as nuk bëhet vlerësim sistematik i strategjive sektoriale.

Në përgjithësi, vlerësohet se nuk ka një sistem të mirëfilltë për të monitoruar në mënyrë të rregullt performancën e Qeverisë dhe arritjen e objektivave të deklaruara të politikave, kjo për shkak se dokumentet vjetore të planifikimit nuk janë të orientuara në rezultate dhe mungojnë treguesit dhe synimet e duhura. Raportet vjetore nuk janë konsistente dhe i mungon një pasqyrë koherente e zbatimit të programit legjislativ. Po ashtu, nuk ka monitorim të rregullt të zbatimit të strategjive sektoriale.⁶

Përmirësimi i kapaciteteve të Qendrës së Qeverisë dhe Ministrive të Linjës për hartimin e politikave – Qendra e Qeverisë (ZKM, MIE dhe MF) dhe Ministritë e Linjës kanë një rol të rëndësishëm në përgatitjen e iniciativave të reja të politikave. Ministritë kanë tendencë jo gjithmonë të mbajnë bashkëpunim të rregullt me ZKM, MIE dhe MF. Departamentet për Integrit Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP) ekzistojnë në të gjitha ministritë dhe janë përgjegjëse për planifikimin dhe koordinimin e politikave dhe bashkërendimin e çështjeve të IE. Nuk ka ndarje të veçanta brenda DIEKP për përmbushjen e këtyre funksioneve. Duke gjykuar nga cilësia e dokumenteve strategjike të propozuara, kapacitetet në ministritë e linjës duhet të zhvillohen më tej. Ngritja e kapaciteteve po ashtu vlerësohet si e nevojshme edhe për zyrtarë të përfshirë në koordinimin e politikave dhe planifikimit si dhe menaxhim të politikave që vijnë nga departamentet qendrore koordinuese (Zyra për Planifikim Strategjik, Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Zyra Ligjore), përfaqësues të ministrive me mandat për koordinim - Ministria e Integritit Evropian dhe Ministria e Financave.

Analizë krahasuese me vende të tjera

Vende të ndryshme i kanë vënë theks të ndryshëm vendosjes së sistemit të planifikimit të integruar dhe po ashtu kanë aplikuar qasje dhe modele të ndryshme, të kushtëzuara nga prioritetet, kushtet dhe strukturat e udhëheqjes së vendit. Në disa vende janë vendosur qendra të qeverisë plotësisht të integruara, të cilat po jetësojnë rëndësinë e tyre si pjesë qenësore e qeverisjes. Ndër këto shtete përfshihen edhe: Lituania, Letonia dhe Kroacia. Në të tri rastet janë ndërmarr reforma në vendosjen e një sistemi të integruar të planifikimit, por që të tri dallojnë për nga qasja dhe mënyra

⁶ Raporti i monitorimit të Parimeve të Administratës Publike për Kosovën. Maj 2016:
<http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2016-Kosovo.pdf>

e vendosjes së sistemit. Një faktor shumë i rëndësishëm i suksesit të sistemit të planifikimit të integruar është komunikimi ndërmjet planifikimit të politikave dhe atij financiar. Mirëpo, sipas vlerësimeve nga raporte të ndryshme asnjë nga vendet e analizuara nuk kanë arritur të vendosin të gjitha elementet e sistemit të integruar në vend.

Lituania - Sistemi i planifikimit strategjik të Lituanisë u prezantua në vitin 2000 dhe është përditësuar disa herë që nga ai vit. Në nivel të qendrës së qeverisë, sistemi i planifikimit përfshin të gjitha fazat (planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin) e menaxhimit të performancës strategjike dhe operative. Dokumentet kryesore strategjike përfshijnë strategjinë afatgjatë 'Lituania 2030' dhe atë afatmesëm 'Programin për Progres Kombëtar', i cili është i lidhur me planet strategjike afatshkurtra dhe programet buxhetore. Sistemi i Planifikimit Strategjik në përgjithësi është i institucionalizuar, funksionimi i tij është i mbështetur nga një rrjet i njëjësive strategjike të planifikimit brenda çdo ministrie dhe një Komiteti Strategjik Qeveritar. Përveç kësaj, çështjet strategjike diskutohen rregullisht gjatë takimeve të anëtarëve të qeverisë apo përfaqësuesve të ministrisë. Këshilli Shtetëror për Progres i përbërë nga politikanë, nëpunës publikë, akademikë, biznesmenë dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë lituaneze, u krijua për të ndihmuar në hartimin e strategjisë 'Lituania 2030' dhe monitoron zbatimin e saj. Edhe pse këto organe strategjike dhe këshillimore pritet të ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme të politikëbërjes dhe vendimmarrjes politike, ndikimi i tyre në vendimmarrje qeveritare në fakt ndryshon nga një çështje specifike në tjetrën. Po ashtu, ka raste kur ekziston hendeku në mes të qëllimeve të politikave afatgjata të përfshira në dokumentet e ndryshme strategjike dhe praktikave aktuale të organizatave individuale në sektorin publik. Përveç kësaj, disa herë janë ndërmarr vendime politikisht të rëndësishme, pa marrë në konsideratë prioritetet strategjike dhe rezultatet e monitorimit të performancës, me dokumentet strategjike të planifikimit dhe të raporteve të ecurisë, të cilat shpesh luajnë pak rol në proceset e përditshme vendimmarrëse.

Lituania ka riorganizuar Zyrën e Qeverisë në Zyrën e Kryeministrit, duke pasur parasysh po ashtu edhe kryerjen e funksionit për të ndihmuar në formulimin dhe zbatimin e politikave qeveritare. Gjithashtu, zhvillimi i instrumenteve vendimmarrëse të bazuara në dëshmi, si për shembull sistemi për monitorim të informacionit, sistemi për vlerësim të programit buxhetor dhe sistemi për vlerësim të ndikimit, ka rritur kapacitetin e qeverisë për të monitoruar dhe vlerësuar vendimet dhe punën e saj bazuar në agjendën politike të qeverisë. Megjithatë, lidhur me vlerësimin e koordinimit të politikave në Lituanë, OECD kohët e fundit ka rekomanduar krijimin e një plani të integruar strategjik për rregullim më të mirë, një organ koordinues të nivelit të lartë, dhe një njësi për rregullim më të mirë brenda qendrës së Qeverisë.

Letonia - ka themeluar një njësi të re të planifikimit në kuadër të Qendrës së Qeverisë, Qendrën e Koordinimit Ndër-Sektorial (QKNS), e cila ka për mandatë të zhvillojë një qasje strategjike afatgjatë për hartimin e politikave publike, për të monitoruar vendimmarrjen dhe për të siguruar që politikatat publike janë efektive. QKNS gjithashtu monitoron progresin e ministrive drejt përmbushjes së qëllimeve të deklaruara të Qeverisë, siç është përcaktuar në Deklaratën e Qeverisë. Deri më tani, QKNS ka zhvilluar Planin Kombëtar të Zhvillimit, si dhe ka vendosur dhe siguruar rolin e saj aktiv në vendimmarrje, duke kontribuar në debatet politike mbi një sërë çështjesh ndër-sektoriale. QKNS shqyrton të gjitha propozimet e diskutuara nga Qeveria dhe ofron konferenca javore për Kryeministrin për çështjet thelbësore në pritje për diskutim nga ana e kabinetit. Në vitin 2015, mandati i QKNS-së u zgjerua për të përfshirë rolin koordinues në menaxhimin e ndërmarrjeve shtetërore. Njësitë e planifikimit të cilat ekzistojnë nëpër ministri, angazhohen në

bashkëpunim me QKNS në fazat e hershme të hartimit të politikave.

Si përfundim, formimi i QKNS-së, e cila i raporton drejtpërdrejt Kryeministrit, ka ofruar një mekanizëm të përshtatshëm i cili mundëson ofrimin e inputit nga Zyra e Kryeministrit dhe nga ministrinë e linjës për përmbajtjen e propozimeve të politikave. QKNS vlerëson të gjitha propozimet që do të adresohen nga qeveria në baza javore, duke u fokusuar në tri çështje: ndikimin ndër-sektorial, respektimin e Deklaratës së Qeverisë dhe pajtueshmërinë me dokumentet strategjike afatgjata (si Plani Kombëtar për Zhvillim).

Kroacia – Kroacia ka filluar me vendosjen e mekanizmave për planifikim dhe menaxhim strategjik në kuadër të administratës publike të vendit. Në nivelin e qendrës së qeverisë, planifikimi strategjik gjatë dekadës së fundit ka qenë i dominuar nga qëllimi i anëtarësimit në BE, ndërsa që nga anëtarësimi në BE në vitin 2013, kapaciteti i planifikimit strategjik është rritur ndjeshëm, pjesërisht për shkak të mësimave të nxjerra gjatë periudhës së anëtarësimit, por edhe në saje të përfshirjes së Kroacisë në ushtrimin e planifikimit strategjik të BE-së të organizuar në kuadër të Semestrit Evropian. Shembujt më të fundit të përmirësimit të planifikimit strategjik mund të gjenden në Programin Kombëtar për Reformën Ekonomike, e cila përcakton masat e reformave strukturore të ndërmarra nga Qeveria në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Programit të Konvergencës Prill 2015, që kanë për synim lidhjen e politikave ekonomike të Kroacisë me qëllimet e përcaktuara bashkërisht dhe me dispozitat e BE-së në fushën e politikës makroekonomike.

VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Qëllimi kryesor i përmirësimit të sistemit të planifikimit në Kosovë është evitimi i fragmentimeve dhe dyfishimeve ndërmjet proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atij financiar, si element thelbësor për të adresuar sfidat ekzistuese me qëllim të fuqizimit të administratës në kontekst të përgatitjeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI) përbënë një kuadër të gjerë të planifikimit dhe monitorimit i dizajnuar për të siguruar që proceset qendrore të politikave dhe ato buxhetore të Qeverisë së Kosovës funksionojnë në mënyrë koherente, efikase dhe të integruar. Përmes këtyre intervenimeve reformat e planifikuara do të:

- mundësojnë planifikimin dhe koordinimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të qeverisë, përfshirë edhe caktimin e prioriteteve lidhur me çështje që kanë të bëjnë me hyrjen dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE);
- krijojnë politika substanciale dhe konsekuente që janë të përballueshme, ekonomikisht efikase dhe financiarisht të qëndrueshme;
- përfshijnë konsultimin me palët e brendshme dhe të jashtme të interesit;
- sigurojnë se politikat zbatohen, komunikohen dhe monitorohen si duhet;
- mbështesin transpozimin dhe zbatimin e acquis në të gjithë sektorët;
- vënë gurthemet për të funksionuar në mënyrë efektive si shtet anëtar i BE-së.

Për ta realizuar vizionin e kësaj strategjie, dhe synimet politike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave përfshinë katër objektiva, të cilat mbulojnë fushën e përgjegjësisë së institucioneve të qendrës së Qeverisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integritit Evropian. Zbatimi i reformave të përzgjedhura me këtë Strategji përfshijnë periudhën 2017-2021.

Objektivat strategjike përfshijnë si në vijim:

- ✚ **Objektivi Strategjik #1: Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, duke përmirësuar ndërlidhjen e dokumenteve strategjike, nëpërmjet koordinimit dhe vendimmarrjes më të mirë.**
- ✚ **Objektivi Strategjik #2: Ndërlidhja më e mirë e kornizës për planifikim strategjik me planifikimin e resurseve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përballueshmërinë financiare dhe zbatimin e planeve strategjike.**
- ✚ **Objektivi Strategjik #3: Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit për të siguruar rezultate më të mira të zbatimit dhe llogaridhënies për përmbushjen e objektivave të vendosura të Qeverisë.**
- ✚ **Objektivi Strategjik #4: Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.**

INTERVENIMET KRYESORE TË STRATEGJISË

I. Përmirësimi i mëtutjeshëm i kornizës së planifikimit strategjik

Objektivi Strategjik #1: Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, duke përmirësuar ndërlidhjen e dokumenteve strategjike, nëpërmjet koordinimit dhe vendimmarrjes më të mirë.

Ky objektivi fokusohet në harmonizimin dhe ndërlidhjen e të gjitha dokumenteve planifikuese, duke përfshirë edhe dokumentet që derivojnë nga procesi i integritit evropian, përmes fuqizimit të mekanizmave koordinues dhe institucional dhe vendosjes së një kalendari të integruar të planifikimit strategjik. Përmirësimi i planifikimit strategjik të politikave sektoriale dhe kombëtare për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së dhe të prioritetëve të tjera, bazuar në një qasje të harmonizuar me kornizën kombëtare, me qëllim të përgatitjes për fazën e ardhshme të aderimit në BE përbënë një fokus tjetër të rëndësishëm. Gjithashtu, fokus tjetër i këtij objektivi është konsolidimi i kornizës strategjike sektoriale, përmirësimi i cilësisë së planifikimit sektorial, duke përfshirë kostimin dhe prezantimin e indikatorëve të performancës gjatë procesit të planifikimit.

Objektivi specifik 1.1: Ndërlidhja e dokumenteve kryesore strategjike me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe sigurimi i zbatimit të saj

Qeveria e Kosovës tashmë ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH). Miratimi i një dokumenti afatgjatë si SKZH padyshim ka shënuar një zhvillim të sistemit të planifikimit të politikave dhe monitorimit në Kosovë. Si i tillë është një hap i rëndësishëm drejt vendosjes së orientimit strategjik në mënyrë që planifikimi qeveritar të jetë më i fokusuar. Në anën tjetër fokusi i Qeverisë po ashtu është i orientuar drejt përmirësimit të planifikimit të politikave kombëtare për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, me qëllim të përgatitjes për fazën e ardhshme të aderimit në BE.

Si një mekanizëm për monitorim efektiv të SKZH-së me fokus në zbatim dhe jetësim të masave është Udhërrëfyësi për Zbatimin e SKZH-së. Ky është një dokument i standardizuar në kuadër të SKZH-së, i cili krahas planifikimit për vitin aktual do të përfshijë informata të mjaftueshme për tri vitet vijuese. Planifikimi vjetor, siç është aktualisht, mund të reflektoj buxhetin e fundit të miratuar dhe të udhëzoj aktivitetet përkatëse, ndërsa informatat për vitet tjera do të udhëzojnë propozimet për KASH.

Në anën tjetër, në kuadër të dialogut për qeverisje ekonomike me Bashkimin Evropian, Kosova ka përgatitur deri më tani dy cikle të Programit për Reforma në Ekonomi (PRE). Ky Program mbulon periudhën afatmesme tri vjeçare dhe bazohet në kornizën makro-fiskale, prioritetet e reformave strukturore dhe masat përkatëse që janë pjesë e Programit të Qeverisë 2015-18 dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-21. Në parim, SKZH dhe PRE janë mirë të ndërlidhura me njëra tjetrën, dhe në një mënyrë, janë pjesë e një pakoje të njëjtë.

Si rrjedhojë, përmes kësaj objektive do të fuqizohet edhe më tutje korniza e planifikimit strategjik, duke siguruar ndërlidhjen dhe harmonizimin e dokumenteve kryesore planifikuese dhe sigurimin e zbatimit të tyre përmes planifikimit operacional.

Objektivi specifik 1.2: Përmirësimi i planifikimit strategjik të politikave për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së

Strategjia Kombëtare për Zhvillim thekson vizionin e Kosovës për rritje ekonomike dhe integrim evropian, një rrugë e vështirë dhe e gjatë për t'u arritur. Megjithatë, të dy këto elemente të vizionit kombëtar janë ngushtë të lidhur me njëri-tjetrin. Me nënshkrimin e MSA-së, zbatimi i saj tani është prioritet strategjik dhe forcë shtytëse e vizionit kombëtar dhe synimeve të politikave që mbulojnë SKZH-në dhe strategjitë sektoriale. Ky proces do të ndikoj në çdo sektor dhe identifikoj zotime të hollësishme nga shumica e ministrive. Për këtë qëllim kërkohet përpjekje e përbashkët nga Ministria e Integritimit Evropian, ZKM/ZPS dhe Ministria e Financave për të ofruar plan të hollësishëm dhe metodologji mbi rolin përkatës të Integritimit Evropian në SKZH dhe KASH dhe mekanizmat të integritimit të komponentëve të ndryshëm të saj në proceset e përgjithshme të sistemit për planifikim të integruar.

Së fundi, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komisioni Evropian kanë lansuar Agjendën Evropiane të Reformave. Agjenda do të shërbej si platformë për identifikimin e prioritetëve kyç në kuadër të procesit të Integritimit Evropian që do të sigurojnë zbatimin e MSA-së. Përveç dialogut politik, zbatimi i saj në nivel të politikave/sectorëve do të monitorohet rregullisht përmes kornizës së përbashkët institucionale të themeluar me MSA, dhe do të rishikohet çdo fund vit.

Duke marrë parasysh se orientimi strategjik për planifikimin e Agjendës Evropiane do të duhej të integrohet plotësisht në kuadër të Sistemit për Planifikim të Integruar, përmirësimet e procesit duhet të orvaten të sigurojnë ndërlidhjen mes Agjendës Evropiane, në njërin anë, dhe SKZH-së, KASH-it, PVPQ-së dhe strategjive sektoriale, në anën tjetër. Krahas kësaj, qëllim kryesor i kësaj objektiviteti është sigurimi i përfshirjes së zotimeve të MSA-së në proceset tjera planifikuese, në veçanti buxhetimin e tyre, duke paraqitur planifikim më koherent dhe të realizueshëm. Kjo do të mundësojë rritjen e nivelit të zbatimit të PKZMSA, si rrjedhojë e një procesi të mirëfilltë të prioritizimit dhe koordinimit.

Objektivi Specifik 1.3: Konsolidimi i Kornizës së Strategjive Sektoriale

Raporti hierarkik ndërmjet SKZH-së si dokument i natyrës afatgjate dhe strategjive sektoriale është shumë i rëndësishëm. Në situatë ideale, zbatimi i prioritetëve të SKZH-së duhet të kalojë përmes prioritetëve më të larta të strategjive sektoriale, të cilat do të funksionalizohen nëpërmjet KASH-it, buxhetimit vjetor dhe planifikimit vjetor të punës.

Konsolidimi i dokumenteve të strategjive sektoriale do të jetë hapi i parë për përmirësimin e planifikimit sektorial. Strategjitë sektoriale do të jenë themeli i sistemit të ri, duke integruar planifikimin e politikave dhe atë financiar dhe duke lidhur planifikimin afatgjatë dhe afatmesëm me procesin e buxhetit.

Nga një perspektivë e tillë, hendeku në planifikimin mbarë sektorial duhet të adresohet tashmë pas aprovimit të SKZH-së. Institucionet që akoma nuk kanë një qasje të unifikuar duhet të konsolidojnë dokumentet kryesore të tyre dhe ato që e kanë bërë këtë duhet t'i avancojnë strategjitë sektoriale, duke i përshtatur prioritetet e SKZH-së. Ky harmonizim është i nevojshëm për aspekte të SKZH-së që mund të konkurrojnë kundrejt "prioritetëve" më të ulëta.

Sa i përket kornizës strategjike, SKZH dhe pjesa më e madhe strategjive sektoriale duhet të marrin parasysh kërkesat e Integritimit Evropian ose planeve përkatëse (PKZMSA), qofshin aspekte legislative, të politikave ose institucionale. Si rrjedhojë, të gjitha kërkesat e Planit për Zbatimin e

MSA-së duhet të ndërliiden me planet përkatëse planifikuese të ministrive dhe të reflektohen në prioritetet, synimet, objektivat, aktivitetet, produktet dhe buxhet. Për të arritur këtë, PKZMSA duhet të bëhet dokument planifikues tre vjeçar, i harmonizuar me strategjitë sektoriale dhe KASH (dhe SKZH) si në aspektin substancial dhe kohor, përderisa sigurohet fleksibiliteti i rishikimit vjetor sipas nevojës.

Objektivi Specifik 1.4: Përmirësimi i Procesit të Koordinimit dhe Vendimmarrjes në nivel qendror dhe në nivelin e ministrive

Implikimi kryesor i sistemit të ri të planifikimit për vendimmarrësit është nevoja që qeveria të marr një rol më strategjik dhe të angazhohet në faza të hershme të proceseve të planifikimit. Kjo synohet të arrihet përmes funksionalizimit të strukturave ekzistuese të planifikimit, dhe krijimit të mekanizmave të njëjtë në kuadër të ministrive.

E tërë kjo duhet të funksionoj përmes një kalendari të integruar të planifikimit, i cili në mënyrë efektive rendit të gjitha veprimet dhe pikat e vendimmarrjes, duke rezultuar në integrimin e proceseve të ndryshme të planifikimit (në rastin më të mirë) ose harmonizimin maksimal (sipas mundësive).

(i) Përmirësimi i koordinimit të politikave dhe procesit të vendimmarrjes në nivel të qendrës së Qeverisë

Komisioni për Planifikim Strategjik, i udhëhequr nga Kryeministri, i formuar në janar 2016, do të jetë struktura në krye të arkitekturës së SPI-së. Në thelb, Komisioni për Planifikim Strategjik do të jetë përgjegjës për drejtimin e procesit të planifikimit të politikave para vendimmarrjes përfundimtare nga Qeveria.⁷

KPS do të mbështetet përmes një kalendari të integruar vjetor dhe në nivelin teknik nga një mekanizëm koordinues ndërinstucional përmes Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS).⁸ ZPS duhet të funksionoj si njësi e brendshme e ZKM-së në mbështetje të punimeve të Komisionit për Planifikim Strategjik.

Komisioni për Planifikim Strategjik do të përfshihet në vendimet kryesore të planifikimit para procedimit të tyre për miratim në Qeveri, duke përfshirë: caktimin e prioritetëve strategjike të Qeverisë, shqyrtimin e nismave të politikave të reja para procedimit në Qeveri, përcaktimin e kufijve agregatë dhe sektorial të KASH-it, finalizimin e KASH-it, shqyrtimin e çështjeve strategjike lidhur me investimet publike dhe ndihmën e jashtme, etj.

(ii) Përmirësimi i koordinimit të politikave dhe vendimmarrjes në nivelin e ministrive

Me fuqizimin e koordinimit të politikave në nivelin qendror, sfida tjetër do të jetë përmirësimi (bazuar në qasjen e njëjtë) i procesit të koordinimit të politikave dhe vendimmarrjes në nivelin e ministrive të linjës.

Në kuadër të secilës ministri duhet të krijohet Grupi për Menaxhim Strategjik (duke pasqyruar qasjen e KPS-së, por në nivelin e secilës ministri të linjës). GMS duhet të kryesohet nga Ministri. Staf i lartë i ministrisë do të formojë Grupin për të siguruar cilësinë e vendimmarrjes dhe monitorimin e zbatimit të planeve të ministrive në kuadër të SKZH-së, agjendës së Integritimit

⁷ Vendimi i Qeverisë Nr. 02/70 i datës 15 janar 2016: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_së_70-të_të_Qeverisë_së_Republikës_së_Kosovës_2016.pdf


⁸ GDPS përbëhet nga përfaqësues të lartë të nivelit teknik të ZKM, MF, MIE, MAP dhe MZHE.

Evropian për sektorin, Strategjitë Sektoriale, KASH-in, planet për investime publike dhe ndihmë të jashtme.

GMS do të përfshihet në të gjitha vendimet kryesore të planifikimit para procedimit të mëtejshëm për shqyrtim dhe miratim në KPS dhe Qeveri, duke përfshirë: përcaktimin e prioriteteve strategjike të sektorit dhe nismave të politikave të reja; miratimin e strategjive sektoriale/ndërsektoriale; përcaktimin e kufijve agregatë të sektorit dhe programeve para procedimit në MF; finalizimin dhe miratimin e propozimeve të sektorit për KASH/Buxhet vjetor; shqyrtimin dhe miratimin e kontributit të sektorit për PVPQ para dorëzimit në SKQ. GMS duhet të drejtohet nga Ministri (ose Zëvendës Ministri në emër të tij/saj); i koordinuar nga Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë dhe në përbërje të drejtorëve të departamenteve kryesore.

Duke marr parasysh situatën e fragmentuar në aspektin e planifikimit, është e nevojshme vendosja e një kalendarit vjetor të integruar të planifikimit. Kalendarit Vjetor i Integruar në mënyrë efektive duhet të rendit të gjithë hapat dhe pikat e vendimmarrjes në proceset e ndryshme të planifikimit, komponentët e SPI-së në mënyrë që ato bashkohen në pikat e duhura të vendimmarrjes. Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik duhet ta përgatisë atë si një prej detyrave të para të vitit. Drafti i kalendarit të integruar duhet t'i prezantohet KPS-së dhe në fund të miratohet në Qeveri.

Struktura institucionale e Sistemit të Planifikimit të Integruar për Planifikim Strategjik



Treguesit dhe rezultatet kryesore					
Treguesit	Njësia	Treguesi bazë/2016	Rezultati i synuar 2018	Rezultati i synuar / 2021	Referenca
Objektivi specifik 1.1 Ndërlidhja e dokumenteve kryesore strategjike me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe sigurimi i zbatimit të saj					
1. Përqindja e ndërlidhjes së Planit Vjetor të Punës së Qeverisë me SKZH (përmes udhërrëfyesit për zbatimin e SKZH-së)	%	40% ⁹	60%	95%	PVPQ Raporti vjetor
2. Përqindja e ndërlidhjes së PKZMSA-së me SKZH (përmes Udhërrëfyesit për zbatimin e SKZH-së)	%	0	40%	60%	PKZMSA,
Objektivi specifik 1.2 Përmirësimi i planifikimit strategjik të politikave për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së					
3. Përqindja e masave afatshkurtra të PKZMSA-së të reflektuara në PVPQ (përfshirë Strategjinë Legjislative të Qeverisë);	%	58%	80%	90%	Raporti i PKZMSA, PVPQ
4. Shkalla e zbatimit të Planit të Veprimit të Agjendës për Reforma Evropian	%	0	70%	95%	Raporti i PKZMSA, PVPQ
5. Shkalla e zbatimit të masave afatshkurtra të PKZMSA-së	#	40%	70%	90%	Raporti i PKZMSA, PVPQ
Objektivi specifik 1.3 Konsolidimi i Kornizës së Strategjive Sektoriale					
6. Numri i strategjive të miratuara që dalin nga SKZH në raport me strategjitë e miratuara jashtë fushëveprimit të SKZH-së	%	0	30%	90%	Raporti për zbatimin e PVDS
7. Shkalla e strategjive të miratuara para vitit 2016 të konsoliduara me kornizën strategjike	%	0	20%	90%	Strategjitë e miratuara sipas SKZH
Objektivi specifik 1.4 Përmirësimi i Procesit të Koordinimit dhe Vendimmarrjes në nivel të qendrës së Qeverisë dhe të ministrive					
8. Numri i ministrive që kanë adaptuar strukturat sipas SPI-së dhe kalendarin e integruar.	#	0	7	19	Vendimet e Qeverise/Ministrit

⁹ Vlerësimi i ndërlidhjes i bërë nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë për PVPQ 2016. Ky vlerësim përfshinë vetëm nivelin strategjik të ndërlidhjes, pra masat e SKZH-së dhe aktivitetet e masave.

8. Përqindja e zbatueshmërisë së Kalendarit të Integruar të Planifikimit.	%	0	50%	80%	Raportet e takimeve të KPS dhe GDPS
Rezultatet kryesore					
<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e Udhërrëfyesit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe vendosja e sistemit për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e SKZH dhe PRE; 2. Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet Programit për Zbatimin e MSA-së dhe Planit Vjetor të Punës së Qeverisë, duke siguruar paraqitje më reale të veprimeve përkatëse në dy dokumentet dhe rritje të përqindjes së realizimit; 3. Ngritja e cilësisë së zhvillimit të strategjive sektoriale, duke rishikuar udhëzimet dhe metodologjinë për hartimin e dokumenteve strategjike, duke përfshirë kostimin dhe prezantimin e indikatorëve të performancës; 4. Vendosja e hierarkisë së dokumenteve planifikuese dhe zhvillimi i strategjive sektoriale në pajtuesmëri me nevojat e SKZH-së, duke qartësuar tipologjinë e dokumenteve dhe vendosur kritere për strategjitë që mund të miratohen nga ana e qeverisë apo të trajtohen në forma të tjera. 5. Sistemi i Planifikimit të Integruar funksionalizohet përmes mekanizmave koordinues, dhe zbatohet përmes kalendarit për planifikim të integruar. 					

II. Ndërlidhje më e mirë ndërmjet dokumenteve strategjike dhe burimeve financiare

Objektivi Strategjik #2: Ndërlidhja më e mirë e kornizës për planifikim strategjik me planifikimin e resurseve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përballueshmërinë financiare dhe zbatimin e planeve strategjike.

Ky objektivi synon fuqizimin e ndërlidhjes ndërmjet dokumenteve afatmesme planifikuese të Qeverisë (SKZH, PKZMSA, PRE) me KASH dhe buxhetin vjetor; rritje të ndërlidhjes ndërmjet projekteve për investime publike me prioritetet e SKZH-së dhe strategjitë sektoriale përmes një dialogu dhe procesi konsistent të prioritizimit, si pjesë përbërëse e planifikimit të KASH-it/buxhetit vjetor; dhe menaxhim efektiv të ndihmës së jashtme, duke fuqizuar proceset e planifikimit dhe programimit me qëllim të harmonizimit dhe ndërlidhjes të fondeve të jashtme me prioritetet e Qeverisë dhe KASH.

Kosova ka shënuar progres të dukshëm në përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor. Megjithatë, përkundër progresit të dukshëm, është e nevojshme të punohet në përmirësimin e përkthimit të prioriteteve kombëtare dhe sektoriale në KASH dhe buxhetin vjetor. Ndërlidhja ndërmjet KASH/buxhetit vjetor me strategjitë mund të përmirësohet dhe të bazohet në një proces efektiv të prioritizimit dhe vendimmarrjes. Kjo po ashtu ndërlidhet me përmirësimin e mundësisë së kostimit dhe prioritizimit të politikave.

Natyra e ndryshimeve të propozuara lidhur me përmirësimin e kornizës planifikuese të KASH-it dhe planifikimit të buxhetit vjetor është gjithëpërfshirëse. Këto ndryshime po ashtu janë artikuluar përmes Strategjisë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) të Kosovës 2016-2020. Kjo strategji, ndër prioritet strategjike ka vendosur edhe zhvillimin e mëtejshëm të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), me synim të avancimit të mëtejshëm të rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme.

Ekziston një ndërlidhje e masave të parapara në kuadër të SRMFP të cilat forcojnë zbatimin e SPPKP, ku SRMFP adreson çështjet në vazhdim: funksionalizimin e strukturave për planifikim

strategjik, përkatësisht Komisionit për Planifikim Strategjik dhe Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik; zhvillimin e kapaciteteve për vlerësimin e ndikimit buxhetor sipas Udhëzimit Administrativ (UA) 03/2015 për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për nismat e reja të Qeverisë; adresimin e devijimeve ndërmjet kufirit të KASH-it dhe kufirit të buxhetit vjetor; zbatimin e qasjes sektoriale në përgatitjen e KASH, etj.

Megjithatë, krahas intervenimeve të përcaktuara në SRMFP, duke mënjanuar mundësitë e dyfishimeve ndërmjet dy dokumenteve kjo strategji synon të adresojë disa sfida në kontekst të planifikimit strategjik të KASH dhe ndërlidhjes me dokumentet kryesore planifikuese. Në përgjithësi, përmes intervenimeve në këtë strategji synohet përmirësimi i kostimit të strategjive sektoriale dhe mundësimi që të njëjtat të shërbejnë për të informuar procesin e KASH-it dhe buxhetit vjetor. Gjithashtu, një aspekt tjetër me rëndësi të madhe është edhe përmirësimi i paraqitjes së zotimeve të agjendës evropiane në KASH dhe buxhetin vjetor.

Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i orientimit strategjik të KASH/buxhetit

Synimi kryesor i kësaj objekteve specifike është përmirësimi i orientimit strategjik të dokumenteve të KASH-it/buxhetit. Kjo synohet të arrihet përmes funksionalizimit të strukturave të planifikimit, përkatësisht Komisionit për Planifikim Strategjik, duke u bazuar në kalendarin e integruar të planifikimit. Përmes kësaj synohet përfshirja e nivelit të lartë politik qysh në fillim të procesit të përgatitjes së KASH-it/buxhetit, që si rrjedhojë pritet të ketë përmirësime të planifikimit dhe priorizimit të politikave për t'u financuar në periudhën afatmesme (shiko objektiven strategjike #1).

Duke u ndërlidhur me Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike, është me rëndësi se buxheti i bazuar në programe është pjesë përbërëse e reformave për orientim më të mirë strategjik të KASH-it dhe buxhetit vjetor. Këto janë parashikuar në SRMFP dhe në këtë dokument do të jepet vetëm si referencë.

Rregullorja e Punës së Qeverisë përcakton nxjerrjen e një deklaratë të prioriteteve, e cila shërben si bazë e politikave për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), Buxhetit dhe Planit Vjetor të Punës së Qeverisë. Duke marr parasysh vlerësimet e deritanishme, është me rëndësi përmirësimi i cilësisë së deklaratës, duke qartësuar më tepër synimet e paraqitura dhe përfshirjen sa më të madhe të agjendës evropiane në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të SKZH-së, është i nevojshëm një proces konsistent i priorizimit dhe vendimmarrjes. Në këtë mënyrë, përmes Udhërrëfyesit për zbatimin e SKZH-së, Qeveria zotohet të integrojë kornizën e vet të planifikimit strategjik për t'u siguruar që burimet financiare të kërkuara për zbatim të Udhërrëfyesit të jenë plotësisht në dispozicion brenda periudhës kohore të pritur. Ministri i Financave siguron se veprimet e SKZH-së gëzojnë qasje preferenciale ndaj burimeve financiare, duke filluar prej alokimit të kufijve buxhetorë në KASH dhe pastaj në mënyrë specifike në buxhetin vjetor.

Edhe pse është e obligueshme, ndërlidhja e strategjive me KASH nuk është bërë deri më tani. Prandaj, rritja e ndërlidhjes së KASH-it dhe dokumenteve strategjike sektoriale duhet të përmirësohet; me vendosjen e SKZH-së dhe rishikimin ose miratimin e strategjive të reja sektoriale pritet një përmirësim i procesit; me theks të veçantë në vitin 2017 duhet të vihet fokusi në harmonizimin e procesit të Integritimit Evropian dhe reflektimin e Programit të Qeverisë në KASH.

Ndërsa si hap për përmirësimin e orientimit strategjik të KASH-it/buxhetit dhe avancimit të mëtejshëm të rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet ardhshme, të cilin e parasheh edhe SRMFP 2016-2020, është funksionalizimi i Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS) dhe i Komisionit për Planifikim Strategjik, struktura të cilat do të realizojnë aktivitete si: shqyrtimi i Deklaratës së Prioriteteve (gjatë periudhës së muajit shkurt); shqyrtimi i dokumentit të KASH (prill) dhe shqyrtimi i draftit të Buxhetit Vjetor (tetor) (për më shumë shih objektivin 4.1 të SRMFP).

Sistemi ekzistues i Programit për Investime Publike (PIP) në Kosovë paraqet një sistem të kënaqshëm për vlerësimin e projekteve dhe (së paku në parim) për prioritizimin e projekteve, por duhet të ndërlidhet në mënyrë më efektive me pjesën tjetër të planifikimit dhe procesit të prioritizimit strategjik.

Objektiva kryesore në kuadër të këtij komponenti është fuqizimi i ndërlidhjes ndërmjet projekteve të investimeve publike me prioritetet e SKZH-së dhe strategjitë sektoriale përmes një dialogu dhe procesi të konsistent të prioritizimit, si pjesë përbërëse e planifikimit të KASH-it/buxhetit vjetor. Është me rëndësi që procesi i planifikimit dhe prioritizimit të investimeve publike të ri-organizohet nga këndvështrimi i arkitekturës së SPI-së.

Aktualisht, Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës 2016-2020, ka vendosur si prioritet të veçantë cilësinë e informatave të buxhetit kapital (Prioriteti 6), ku synohet të arrihet një menaxhim më efikas dhe më efektiv i planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP-it, që do të ndikoj në një planifikim të drejt dhe adekuat të projekteve kapitale e që duhet të jenë të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe me prioritetet e Qeverisë. Kjo ka për synim final uljen e numrit të ri-alokimeve për OB të nivelit qendror dhe rritjen e përqindjes së zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale, krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal (për më shumë mund t'i referoheni Strategjisë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) të Kosovës 2016-2020).

Objektivi specifik 2.2: Përmirësimi i buxhetimit afatmesëm dhe afatshkurtër, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të MSA-së

Si pjesë e dialogut për qeverisje ekonomike me Bashkimin Evropian, Kosova për të tretën herë përgatitë Programin për Reforma Ekonomike. Në parim së bashku me SKZH dhe prioritetet e agjendës evropiane përmes PKZMSA-së, të gjitha këto korniza të planifikimit ofrojnë një qartësim më të madh të prioriteteve dhe mundësojnë orientim të planifikimit në nivele të ndryshme të KASH/buxhetit vjetor si dhe Planit Vjetor të Punës së Qeverisë. Megjithatë, sfida kryesore mbetet në ndërlidhjen dhe harmonizimin e dokumentit strategjik PKZMSA-së me KASH.

Më tej, për të siguruar zbatimin e MSA-së, është i domosdoshëm harmonizimi i orientimit strategjik të KASH-it me prioritetet që përcakton ajo. Për këtë qëllim, risi e PKZMSA-së do të jetë kapitulli *“Deklarata e prioriteteve afatmesme të integritimit evropian për financim nga KASH”*, ku do të përcaktohen dhe përshkruhen prioritetet kyçe afatmesme, të cilat duhet të planifikohen në kuadër të KASH-it dhe të financohen nga buxheti vjetor i shtetit.

Kjo do të shërbejë për procesin e hartimit të Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë¹⁰, duke siguruar që zotimet afatmesme të agjendës evropiane reflektohen në KASH dhe rrjedhimisht buxhetin vjetor. Është me rëndësi të theksohet se ky proces do të koordinohet në kuadër të Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik, për ta prezantuar një dokument të integruar në Komisionin për Planifikim Strategjik para miratimit në Qeveri.

Objektivi specifik 2.3: Menaxhimi efektiv i ndihmës së jashtme

Qëllimi kryesor në kuadër të kësaj objektivie specifike është rritja e kapaciteteve planifikuese, programatike dhe monitoruese të administratës së shtetit për të siguruar menaxhimin efektiv të ndihmës së jashtme, në harmoni me buxhetin e shtetit, me qëllim të zbatimit të prioriteteve strategjike të vendit dhe avancimit të procesit integruar të Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës në vijim, do të shtohen 3 aspekte të reja në kornizën ekzistuese të planifikimit të ndihmës së jashtme:

- **Programi për Asistencën Zhvillimore (PAZH)** – MIE me ndihmën e Komisionit Evropian gjatë periudhës në vijim do të hartojë Programin për Asistencën Zhvillimore. PAZH do të identifikojë prioritetet dhe projektet për financim nga i tërë spektri i komunitetit të donatorëve. Programi do të ofrojë një kornizë koherente të aktiviteteve të donatorëve, në përputhje me buxhetin e shtetit.
- **Zgjerimi dhe përditësimi i Listës Prioritare të Projekteve Infrastrukturore/Single Project Pipeline (SPP)** – MIE do të përditësojë SPP-në, me ç'rast do të përfshihen projektet të reja në kuadër të katër sektorëve ekzistues (transporti, mjedisi, energjia dhe sektorët social) dhe po ashtu do të zgjerohet planifikimi i investimeve infrastrukturore edhe në sektorë të tjerë.
- **Zbatimi i moduleve të ngritjes së kapaciteteve për menaxhimin e ndihmës së jashtme** (për më shumë shih objektiven specifike 4.2).

Treguesit dhe rezultatet kryesore					
Treguesit	Njësia	Treguesi bazë/2016	Rezultati i synuar 2018	Rezultati i synuar / 2021	Referenca
Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i orientimit strategjik të KASH-it/buxhetit					
1. Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të. ¹¹	%	7.5%		3.5%	SRMFP
2. Përqindja e mbulimit të veprimeve të	%	40% ¹²	60%	90%	KASH,

¹⁰ Neni 46 i Rregullores së Punës së Qeverisë, përcakton se “Qeveria nxjerr një deklaratë të prioriteteve e cila shërben si bazë e politikave për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, buxhetit vjetor dhe Planit Vjetor të Punës së Qeverisë. Qeveria do t'i shqyrtojë dhe konfirmojë ose ndryshojë këto prioritetet para fillimit të procesit të kornizës afatmesme të shpenzimeve çdo vit. Zyra për Planifikim Strategjik në ZKM do të bashkërendojnë përgatitjen e Deklaratës Vjetore të Prioriteteve të Qeverisë para se kjo deklaratë të dorëzohet në Qeveri, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Integritimit Evropian dhe Sekretariatit Koordinues të Qeverisë.” Rregullorja e Punës së Qeverisë: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_E_PUNËS_SË_QEVERISË_SË_REPUBLIKËS_SË_KOSOVËS_NR_09_2011.pdf

¹¹ Indikator i përcaktuar në Strategjinë për Reformën e MFP-së

SKZH-së në KASH (përmes udhërrëfyesit për zbatimin e SKZH-së					Udhërrëfyessi i SKZH-së
3. Raporti ndërmjet fondeve të përgjithshme të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe financimit të përgjithshëm të identifikuar për sektorët përkatës në KASH	%	20%	40%	75%	SIGMA
4. Kërkesat e kalendarit të Sistemit për Planifikim të Integruar janë përmbushur për planifikimin financiar, duke përfshirë programin për investime kapitale	Binar	Jo	Po	Po	Raportet e takimeve të GDPS dhe KPS
Objektivi specifik 2.2: Përmirësimi i buxhetimit afatmesëm dhe afatshkurtër, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të MSA-së					
5. Përqindja e prioriteteve kryesore të PKZMSA-së të reflektuar në KASH ¹³	%	0 ¹⁴	80%	100%	KASH, PKZMSA
6. Përqindja e masave afatshkurtra të PKZMSA-së të mbuluara me buxhet vjetor përgjatë tërë vitit.	%	45%	80%	100%	Buxheti vjetor, PKZMSA
Objektivi specifik 2.3: Menaxhimi efektiv i ndihmës së jashtme					
7. Programi për Asistencën Zhvillimore i miratuar dhe i ndërlidhur me KASH i shprehur në përqindjen e mbulimit të prioriteteve	%	0	50%	70%	PAZH, KASH
7. Përqindja e ndërlidhjes së Projekteve nga Lista Prioritare e Projekteve me prioritetet e SKZH-së ¹⁵	%	0	70%	90	SKZH, LPP
Rezultatet kryesore					
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i orientimit strategjik të KASH dhe buxhetit vjetor, duke siguruar përfshirjen e plotë të prioriteteve të SKZH-së dhe PKZMSA në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë, si pjesë përbërëse e KASH-it si dhe përmirësimi i kostimit të produkteve të SKZH-së, dhe PKZMSA për tri vitet e para të KASH-it. • Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë të harmonizohet me dokumentet strategjike si SKZH, PKZMSA, PRE dhe dokumente tjera strategjike. • Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Integritimit Evropian për Financim nga KASH, e përditësuar rregullisht, merret parasysh në hartimin e KASH-it, si dhe shqyrtohet dhe miratohet nga strukturat koordinuese për planifikim të integruar; • Ndërlidhja e PKZMSA me KASH/buxhet vjetor, duke siguruar reflektimin e prioriteteve të agjendës 					

¹² Ky është vlerësim preliminar bazuar në numrin e aktiviteteve dhe masave të SKZH-së, të cilat janë në proces të zbatimit, një vlerësim më i plotë do të bëhet në momentin e finalizimit të Udhërrëfyesit për Zbatimin e SKZH-së

¹³ E shprehur përmes Deklaratës së Prioriteteve afatmesme të integritimit evropian për financim nga KASH, Deklarata do të jetë kapitull i ri i PKZMSA-së përmes së cilës synohet të qartësohen kërkesat për financim të objektivave të agjendës evropiane dhe përfshirjes në KASH.

¹⁴ Duhet të bëhet vlerësim i mbulimit të masave afatshkurtra të PKZMSA-së në KASH

¹⁵ Kjo duhet të përfshijë Programin për Investime Publike dhe Listën e Projekteve Prioritare, të cilat janë të reflektuara në kuadër të klauzolës së investimeve

evropiane në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë dhe si rrjedhojë buxhetimin përkatës të tyre;

- Fuqizimi i shqyrtimit të vlerësimit të ndikimit buxhetor të politikave prioritare nga Ministria e Financave, duke synuar që nismat e reja qeveritare të jenë të kostuara si duhet, si dhe të sigurohet se shpenzimet janë brenda ndarjeve buxhetore. Nën koordinimin e GDPS-së dhe duke përdorur Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave brenda ministrive, ZKM, MIE dhe MF, harmonizojnë procesin e zhvillimit të PVPQ, KASH dhe PKZMSA.
- Përmirësimi i vendimmarrjes për programin e investimeve publike për të siguruar se investimet publike identifikohen përmes proceseve të planifikimit strategjik në kuadër të SPI-së (SKZH/strategjitë sektoriale/KASH);
- Rishikimi i Listës Prioritare të Projekteve Infrastrukturore;
- Dialogu efektiv me komunitetin e donatorëve, përmes zbatimit të Rregullores për Koordinimin e Donatorëve;
- Sistemi efikas i monitorimit të ndihmës së jashtme, me anë të Platformës për Menaxhimin e Jashtëm dhe Raportit Vjetor për Koordinimin e Donacioneve;

III. Integrimi i praktikave dhe proceseve të monitorimit

Objektivi strategjik #3: Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit për të siguruar rezultate më të mira të zbatimit dhe llogaridhënies për përmbushjen e objektivave të vendosura të Qeverisë.

Qëllimi kryesor i objektivit është përmirësimi i sistemit të monitorimit të dokumenteve kryesore të planifikimit, duke përfshirë vendosjen e një procesi sistematik të monitorimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale. Gjithashtu, ky objektivi ka për synim vendosjen e një Sistemi të Integruar të Monitorimit përmes Planit Vjetor të Punës së Qeverisë, me qëllim që të sigurojë për Qeverinë informacionin e nevojshëm në lidhje me monitorimin për të përcjellë zotimet kryesore të saj (duke përfshirë po ashtu të gjitha iniciativat e dakorduara të integritit evropian, ku synohet të avancohet dhe integrohet edhe sistemi i monitorimit dhe raportimit të PKZMSA-së.); dhe t'i sigurojë Qeverisë, institucioneve të Qendrës së Qeverisë, si dhe menaxhmentit të lartë të ministrive informacion të plotë mbi realizimin e planeve operative të ministrive.

Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i monitorimit të strategjive sektoriale duke përfshirë vlerësimin periodik të tyre

Është vlerësuar se raportimi i hollësishëm për zbatimin e strategjive sektoriale është i mangët. Edhe pse ministrinë janë të obliguara të monitorojnë zbatimin e strategjive dhe ZPS mund t'iu kërkojë raporte për zbatimin dokumenteve strategjike që ndërlidhen me prioritetet e Qeverisë, nuk ka kërkesë të rregullt për hartimin e raporteve të zbatimit dhe dorëzimit të tyre në Qeveri, por as nuk bëhet vlerësim sistematik i strategjive sektoriale.

Për të ndryshuar këtë gjendje, do të rishikohet UA 02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë e Hartimit dhe Miratimit të Dokumenteve Strategjike dhe Planeve për Zbatimin e tyre. Ndryshimi i Udhëzimit, krahas aspekteve të nevojshme për sigurim të konsistencës të hartimit të strategjive, synon të përfshijë kërkesën që ministrinë gjatë hartimit të strategjive të fusin indikatorët e performancës. Gjithashtu, risi tjetër do të jetë vendosja e një qasje të unifikuar të monitorimit dhe raportimit të strategjive, për të fuqizuar kërkesën që ministrinë të dërgojnë raporte mbi zbatimin e strategjisë përkatëse. Kjo do të përfshijë gjithashtu kërkesën për vlerësimin periodik të strategjive.

Objektivi specifik 3.2: Fuqizimi i rolit të sistemit të monitorimit të PVPQ-së si mekanizëm për informim të politikë-bërësve dhe rritjes së llogaridhënies të ministrive të linjës

Në analizën e paraqitur më lartë, e cila është e bazuar në raporte të jashtme dhe vlerësime të brendshme të Qeverisë, është theksuar se Qeveria nuk ka një sistem të mirëfilltë për monitorim të rregullt të performancës së saj dhe arritjes së objektivave të deklaruara të politikave. Kjo situatë është si rrjedhojë e mungesës së dokumenteve planifikuese që mundësojnë orientim në rezultate dhe mungesës së indikatorëve të duhur dhe caqeve të performancës. Gjithashtu, konsiderohet se raportimi vjetor nuk është konsistent dhe i mungon një pasqyrë koherente e zbatimit të programit legjislativ.

Ndonëse konsiderohet se monitorimi i PVPQ-së ka funksionuar mirë deri më tani, ekziston nevoja për përmirësime të mëtejshme të tij në mënyrë që të bëhet mekanizmi kryesor që jep informacion më cilësor të arritjeve dhe rezultateve të Qeverisë së Kosovës. PVPQ duhet të përmirësojë informacionin/indikatorët për performancën gjatë zbatimit të politikave prioritare apo synimeve në kuadër të këtyre masave, duke siguruar të dhëna më cilësore për marrjen e vendimeve politike. Gjithashtu, kjo do të mundësonte përmirësim të cilësisë së PVPQ-së, paraqitje më reale të tij dhe rrjedhimisht rritje të nivelit të zbatimit vjetor të zotimeve të Qeverisë.

Njëkohësisht, me këtë planifikimi i procesit të integritit evropian është konsoliduar edhe më tutje gjatë vitit 2016 me përgatitjen e Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Gjithashtu, gjatë vitit 2016 MIE ka vendosur sistemin e ri të monitorimit kuantitativ dhe kualitativ të zbatimit të Programit, me ç'rast MIE ka filluar me hartimin e raporteve të rregullta mbi zbatimin e Programit, në baza tremujore. Megjithatë, është e nevojshme që krahas përmirësimit të ndërlidhjes së PKZMSA-së me buxhetin vjetor, si dhe është me rëndësi të përmirësohet edhe më tutje cilësia e planifikimit të aktiviteteve si dhe avancimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit të PKZMSA-së, duke synuar integrimin me sistemet tjera të monitorimit dhe raportimit, përkatësisht sistemin e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë;

Objektivi specifik 3.3: Sigurimi i koherencës së raportimit nëpërmjet integritit të sistemeve të monitorimit dhe raportimit

Objektivi kryesor në kuadër të këtij komponenti është vendosja e një Sistemi të Integruar të Monitorimit të PVPQ për t'i siguruar Qeverisë informata të monitorimit të nevojshme për të përcjellë zotimet kryesore të Qeverisë (duke përfshirë të gjitha iniciativat e dakorduara të integritit evropian) dhe t'i ofrojë menaxhmentit të ministrive informata gjithëpërfshirëse mbi realizimin e planeve operative të tyre.

Parimet e planifikimit dhe monitorimit të integruar kërkojnë vendosjen e një Sistemi të Integruar të Menaxhimit të Informatave që do të mbulonin të gjitha zotimet qeveritare dhe të ministrive të linjës. Edhe pse, gjatë vitit Qeveria pranon raporte të rezultateve nga burime të ndryshme (SKQ, ZPS, MIE, MF), monitorimi nuk është gjithmonë i lidhur me ciklin e planifikimit. Janë bërë përpjekje të mira gjatë viteve të fundit për të përmirësuar sistemet e monitorimit dhe raportimit në Kosovë dhe janë vendosur disa Sisteme për Menaxhimin e Informatave¹⁶. Megjithatë, kjo ka qarë në monitorim të fragmentuar të ministrive të linjës nga ana e institucioneve të shumta të nivelit qendror duke përdorur formate të ndryshme dhe jo-konsistente. Të gjitha këto sisteme

¹⁶Sistemi i Menaxhimit të Informatave të PVPQ-së, atë për vendimet e Qeverisë; Sistemi për Monitorimin e Programit Legjislativ; Sistem i Menaxhimit të Informatave për Planin e Veprimit për Liberalizimin e Vizave.

funksionojnë në mënyrë të pavarur me ndërlidhje të kufizuar mes vete ose mos-integrim të sistemeve elektronike me njëri tjetrin.

Në parim, zhvillimi i bazave të të dhënave paralele duhet të dekurajohet, duke u bazuar në parimin se monitorimi do të integrohet në PVPQ. Megjithatë, duhet pranuar se, realisht, një pjesë e monitorimit paralel do të ekzistojë i ndarë, për një kohë që sistemi i monitorimit ekzistues nuk mund të anulohet menjëherë. Për shembull, monitorimi i programit për Agjendën e Integritimit Evropian do të marrë një kohë për t'u integruar plotësisht në sistemin e raportimit për PVPQ. Kjo, për shkak të kërkesave shumë specifike të procesit të IE; dinamika e raportimit në KE; institucionet e krijuara (i gjithë procesi i IE menaxhohet në një cikël të plotë të mbyllur nga MIE, ku ZKM dhe MF kanë përfshirje të kufizuar). Prandaj, duhet pasur kujdes në krijimin e sinergjive dhe shmangien e mbivendosjes në mes të Sistemit të Menaxhimit Informativ të PVPQ dhe sistemeve të tjera të monitorimit. Aty ku është e mundur këto sisteme duhet të integrohen, por nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të synojmë harmonizimin maksimal të tyre.

Përfundimisht, integrimi i mundshëm i sistemeve do të mundësonte raportim të integruar për të dyjat - PVPQ dhe PKZMSA, duke u fokusuar në rezultatet dhe impaktin e arritur në krahasim me zotimet dhe buxhetin e miratuar.

Treguesit dhe rezultatet kryesore					
Treguesit	Njësia	Treguesi bazë/2016	Rezultati i synuar 2018	Rezultati i synuar / 2021	Referenca
Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i monitorimit të strategjive sektoriale duke përfshirë vlerësimin periodik të tyre					
1. Përqindja e strategjive sektoriale që kanë raporte vjetore të hartuara dhe publikuara	%	0	40%	90%	Faqja zyrtare e ZKM
2. Raportet vjetore të strategjive të zhvilluara sipas Udhëzimit Administrativ të rishikuar, po ashtu përfshijnë informata rreth arritjeve kundrejt objektivave (produktet/rezultatet)	%	0	80%	100%	Faqja zyrtare e ZKM
Objektivi specifik 3.2: Fuqizimi i rolit të sistemit të monitorimit të PVPQ-së si mekanizëm për informim të politikë-bërësve dhe rritje të llogaridhënies së ministrive të linjës					
3. Çështjet e pakryera në zbatimin vjetor nga zotimet e planifikuara në dokumentin(et) e planifikimit në nivelin qendror (përqindja e zotimeve të përgjithshme të PVPQ-së të bartura në vitin vijues)	%	26%	15%	10%	SIGMA, Raporti vjetor i punës së Qeverisë
4. Indikatorët e performancës janë zhvilluar dhe përfshirë në PVPQ		NO	YES	YES	PVPQ

5. Çështjet e pakryera në zbatimin vjetor nga zotimet e planifikuara në PKZMSA (përqindja e zotimeve të përgjithshme të PKZMSA-së të bartura në vitin vijues)	%	0 ¹⁷	25%	10%	PKZMSA,
---	---	-----------------	-----	-----	---------

Rezultatet kryesore

- Zhvillimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të strategjive sektoriale duke përfshirë publikimin e tyre.
- Futja e indikatorëve të performancës në procesin e hartimit të strategjive sektoriale.
- Futja e indikatorëve të performancës në PVPQ dhe mundësisht në PKZMSA.
- Avancimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit të PKZMSA-së duke synuar integrimin me sistemet tjera të monitorimit dhe raportimit, përkatësisht sistemin e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë.
- Krijimi i një Plani të Integruar të Monitorimit në secilën Ministri, si një pjesë integrale e PVPQ, me qëllim për të bërë një dallim të qartë ndërmjet aktiviteteve që rrjedhin nga prioritetet e Qeverisë dhe atyre që janë të një rëndësie ministrore dhe për të vendosur fokusin në monitorimin e sektorit/ministrit, si dhe integrimin e të gjitha kërkesave për monitorimin e ministrit/vektorit në fjalë.
- Zhvillimi i një strukture dhe metodologjie zyrtare (bashkërisht nga ZKM (në veçanti SKQ dhe ZPS), MIE dhe MF) për të siguruar qëndrueshmëri dhe metodologji të unifikuar për të gjitha kornizat për planifikim dhe monitorim dhe të përdoret nga SKQ/PVPQ dhe të gjitha ministritë e linjës.
- Vendosja e modaliteteve, roleve dhe përgjegjësisve për monitorimin e implementimit të Udhërrëfyesit të SKZH dhe monitorimit ekzistues, të cilat në parim duhet të bëhen në kuadër të PVPQ, ndërsa ZPS dhe SKQ duhet të zhvillojnë një propozim të përbashkët për adresimin e kësaj çështjeje.
- Përmirësimi i raportimit vjetor të ministrive, duke u fokusuar në rezultatet dhe impaktin e arritur në krahasim me zotimet dhe buxhetin e miratuar.

IV. Ngritja e kapaciteteve për planifikim dhe koordinim të politikave

Objektivi Strategjik #4: Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.

Përmes këtij objektivi synohet të arrihet ndërtimi dhe ngritja e kapaciteteve për proceset e ndryshme të sistemit të planifikimit të integruar, duke u bazuar në intervenimet ekzistuese dhe të planifikuara të institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gjithashtu, theks i veçantë do të vihet në ngritjen e kapaciteteve për fuqizimin e koordinimit dhe strukturave vendimmarrëse, zhvillimin e politikave në kontekst të integrimit evropian dhe menaxhimit të ndihmës së jashtme.

Gjatë kohës së zbatimit të dy strategjive, SPPKP 2017-2021 dhe SRrM 2017-2021, do të vendoset një koordinim i ngushtë në aspektin e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të zbatimit të objektivit për ngritjen e kapaciteteve për planifikimin dhe koordinimin e politikave, e cila përbëhet nga tri komponentët e prezantuar në vazhdim.

Komponenti 1) Ngritja e kapaciteteve për proceset e sistemit të planifikimit të integruar dhe fuqizimin e koordinimit dhe strukturave vendimmarrëse

¹⁷ Vlera bazë është marr për vitin 2015, për shkak se viti 2016 është viti -i parë -i zbatimit të PKZMSA-së dhe nuk mund të vlerësohet se sa janë bartur në vitin vijues

Zhvillimi i programit të fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve (duke përfshi zhvillimin e kurrikulave, organizimin e moduleve të trajnimeve dhe ofrimin e trajnimeve në vendin e punës) për: i) personelin e departamenteve qendrore koordinuese (ZPS, SKQ, ZL); ii) përfaqësues të ministrive, me mandat për koordinim - Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Financave dhe iii) përfaqësuesit e Departamenteve për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në ministritë e linjës, lidhur me:

- a) Proceset e sistemit të planifikimit të integruar;
- b) Zhvillimin dhe menaxhimin e politikave (me fokus në politikat me kontekst të integritimit evropian)

Komponenti II) Ngritja e kapaciteteve planifikuese, programatike dhe monitoruese të administratës publike për menaxhimin e ndihmës së jashtme

Zbatimi i moduleve të ngritjes së kapaciteteve për menaxhimin e ndihmës së jashtme MIE në bashkëpunim me IKAP, dhe me mbështetjen e Komisionit Evropian, do të dizajnoj dhe zbatoj kurrikulën dhe modulet e përhershme për ngritjen e kapaciteteve të administratës për menaxhimin e ndihmës së jashtme. Risi e veçantë do të jetë ndërtimi i një qasje të qëndrueshme të kapaciteteve lokale për të udhëhequr trajnimet, duke u larguar nga qasja konvencionale të ekspertëve ndërkombëtarë dhe aktiviteteve ad-hoc për trajnime.

Komponenti III) Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të monitorimit të integruar duke reflektuar edhe proceset e ndërlidhura me integrimin evropian

Ngritja e kapaciteteve të monitorimit dhe raportimit do të fokusohet në zbatimin e Sistemit të Integruar të Monitorimit në mënyrë që të sigurojë për Qeverinë informata të monitorimit të nevojshme për të përcjellë plotësimin e zotimeve kryesore të Qeverisë (duke përfshirë po ashtu të gjitha iniciativat e dakorduara të Integritimit Evropian) dhe t'i ofrojë menaxhmentit të ministrive informata gjithëpërfshirëse mbi realizimin e planeve operative të ministrive.

Objektivi specifik 4.1: Plotësimi i kapaciteteve të nevojshme për planifikimin dhe koordinimin e politikave

SPPKP 2017-2021 synon të ketë një ndikim të përhershëm që do të thotë se arritjet duhet të jenë të qëndrueshme dhe se ndryshimet e paraqitura duhet të ankorohen në kuadër të administratës së Qeverisë së Kosovës. Mirëpo, kjo qëndrueshmëri pjesërisht varet edhe nga fakti se sa kapacitetet individuale janë forcuar dhe sa masat organizative, të tilla si procedurat e punës, janë efektive.

Megjithatë, deri në një masë të rëndësishme, qëndrueshmëria varet nga institucionet e Qendrës së Qeverisë, dhe veçanërisht në atë që SKQ, ZPS, ZL dhe ZKP në ZKM, duhet të jenë në gjendje të kryejnë detyrat që u janë caktuar në një nivel të kënaqshëm. Në gjendjen aktuale, siç tregohet në raporte të ndryshme (SIGMA) dhe të identifikuar nga vetë ZKP-ja, zyrat e ZKM kanë mungesë të stafit në krahasim me detyrat që i kanë këto zyra. Mos-adresimi i çështjes së stafit dhe mos zgjidhja e mungesës së stafit rrezikon që përparimi i bërë në bazë të kësaj strategjie të stagnoj.

Për të përmirësuar këtë, nën mbështetjen e Projektit të mbështetur nga SIDA, parashihet një proces i vlerësimit të nevojave të ZKM-së për plotësimin me staf, ku do të ofrohet një vlerësim i niveleve aktuale dhe niveleve të nevojshme të stafit për SKQ, ZPS, ZL dhe ZKP dhe do të ofrohen propozime se si mund të përmirësohet funksionimi i ZKM-së në lidhje me detyrat e saj. Ky vlerësim përfshin një analizë të përshkrimeve të punës, praktikave për trajnimin e stafit dhe

politikat e kompensimit. Kjo mundëson që analiza të formoj pikënisjen për diskutimin e niveleve të stafit dhe praktikave të punës me Sekretarin e Përgjithshëm të ZKM-së dhe ndërmarrjen e masave për të adresuar çështjet e identifikuar. Një vlerësim i tillë synohet të zgjerohet edhe në gjithë Qendrën e Qeverisë, me qëllim të sigurimit të niveleve të duhura të personelit të ngarkuar me zhvillimin dhe koordinimin e politikave.

Objektivi specifik 4.2: Ngritja e kapaciteteve për planifikimin dhe koordinimin e politikave

Rekomandime për përmirësimin e sistemit të politikë-bërjes dhe planifikimit, si dhe ngritje të kapaciteteve përkatëse të personelit, janë dhënë nga raporte dhe vlerësime vendore dhe ndërkombëtare të cilat flasin për nevojën ekzistuese për ndërtimin e kapaciteteve për planifikimin dhe koordinimin e politikave.

Ndërtimi dhe ngritja e kapaciteteve do të jetë tejet e rëndësishme për të siguruar zbatimin uniform të iniciativave të reja si dhe për të përmirësuar koordinimin e politikave dhe planifikimit në të gjithë Qeverinë, duke arritur në jetësimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar që nënkupton edhe harmonizimin e roleve, përgjegjësisë dhe mekanizmave për planifikimin dhe koordinimin e politikave sektoriale, nacionale dhe integrimeve evropiane. Ngritja e kapaciteteve do të fokusohet në: i) fuqizimin e koordinimit dhe strukturave vendimmarrëse; ii) zhvillimin e politikave në kontekst të integritit evropian; iii) menaxhimin e ndihmës së jashtme; dhe iv) zbatimin e sistemit të integruar të monitorimit dhe raportimit.

Objektivi për ngritjen e kapaciteteve të personelit të përfshirë në koordinimin e politikave dhe planifikimit, do të fokusohet në projektimin, përgatitjen dhe ofrimin e një programi gjithëpërfshirës të trajnimit për menaxhimin e politikave – i) për personelin e departamenteve qendrore koordinuese (Zyra për Planifikim Strategjik, Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Zyra Ligjore); ii) përfaqësues të ministrive, me mandat për koordinim - Ministria e Integritit Evropian, Ministria e Financave; dhe iii) përfaqësuesit e Departamenteve për Integrit Evropian dhe Koordinim të Politikave në ministrinë e linjës. Këto të fundit janë në fokus të programit të propozuar të trajnimit, duke pasur parasysh mandatin e tyre për koordinimin e politikave të përgjithshme dhe planifikimit strategjik, analizën e politikave dhe mbështetjes metodologjike, koordinimit të donatorëve apo procesit të Integritit Evropian. Ato gjithashtu shërbejnë si homologë të institucioneve qendrore për procese të ndryshme, duke përfshirë zhvillimin/ zbatimin e masave të parapara me Strategjinë për Zhvillim Kombëtar.

Programi për ngritjen e kapaciteteve mëtohet të institucionalizohet dhe të shërbejë si instrument kryesor për ndërtimin e kapaciteteve të nëpunësve relevant, të cilët do të fitojnë njohuri për analizë të politikave dhe planifikim dhe do të sigurojnë se politikat prioritare të Qeverisë janë të zhvilluara, zbatohen dhe monitorohen në mënyrë uniforme me efikasitet dhe efektivitet të lartë. Ky objektivi strategjik parasheh zhvillimin e një kurrikule me modulet e rekomanduara dhe temat e programit të trajnimit, qasja e përgjithshme për përgatitjen dhe ofrimin e trajnimit si dhe rregullimet institucionale që duhet vënë në vend për zbatimin efektiv të programit dhe institucionalizimin e tij.

Bazuar në Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2017-2021, në kuadër të Projektit të mbështetur nga SIDA, parashihen gjithashtu aktivitete trajnuese për stafin e ZKM-së sa i përket një game të gjerë të temave: Trajnime për Trajnerë (TT), Trajnim për Barazi Gjinore, Trajnim mbi Ndeshmërinë ndaj Konfliktit, Komunikim të Politikave, Trajnim për Modelin e Kostimit

Standard dhe trajnime mbi temat e tjera të cilat do të jenë të hapura për të gjitha institucionet e Qendrës së Qeverisë dhe stafin përkatës nga ministritë e linjës.

Treguesit dhe rezultatet kryesore					
Treguesit	Njësia	Treguesi bazë/2016	Rezultati i synuar 2018	Rezultati i synuar / 2021	Referenca
Objektivi specifik 4.2: Ngritja e kapaciteteve për proceset e sistemit të planifikimit të integruar dhe fuqizimin e koordinimit dhe strukturave vendimmarrëse					
1. Numri i trajnerëve të përgatitur për planifikimin dhe zbatimin e MSA-së dhe për zhvillim të politikave	#	0	15	15	
2. Kapacitetet për zhvillim të politikave në kuadër të institucioneve të Qendrës së Qeverisë dhe të gjitha ministrit e linjës janë ngritur përmes programeve trajnuese dhe programeve për trajner	%		25%	75%	
Rezultatet kryesore					
<ul style="list-style-type: none"> Nivelet e stafit të departamenteve brenda ZKM-së, por edhe në tërë QQ (përgjegjës për zhvillimin, koordinimin dhe analizimin e politikave), në proporcion të drejtë krahasuar me detyrat e sektorëve të ndryshëm; Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të departamenteve qendrore koordinuese të Qeverisë dhe të ministrive me mandat për koordinim për: i) proceset e sistemit të planifikimit të integruar; iii) zhvillimin dhe menaxhimin e politikave; iv) zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe strategjive tjera sektoriale; Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve nga ministritë e linjës të cilët janë përgjegjës për proceset e integritit evropian të koordinimit të politikave për: i) zhvillimin, koordinimin e realizimit, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të politikave dhe strategjive në harmoni me kornizat nacionale; ii) planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe raportim dhe monitorim e menaxhimit të ndihmës së jashtme; Përgatitja e një numri të trajnerëve nga zyrtarët e departamenteve qendrore koordinuese të Qeverisë, që përmes trajnimit në punë, të ndihmojnë zyrtarët nga ministritë e linjës për qenë koherent dhe efikas kërkesat e Qeverisë në lidhje me zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike; Ngritja e kapaciteteve për monitorim dhe raportim të PKZMSA-së si dhe të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë; Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës të ministrive të linjës për të përmirësuar raportimin vjetor të ministrive, duke u fokusuar në rezultatet e arritura përballë zotimeve; 					

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Reforma e Administratës Publike

Reforma lidhur me zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe legjislacionit që koordinohen nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së, është një nga tri shtyllat e Reformës së Administratës Publike (RAP), andaj edhe strukturat institucionale për zbatimin e Strategjisë për Përmirësimin e

Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021 do të jenë në një linjë me strukturat të Reformës së Administratës Publike.

Struktura e menaxhimit institucional të Reformës së Administratës Publike (RAP) është përcaktuar nga Qeveria sipas Vendimit të Qeverisë numër 05/09 (datë 21/01/2015) për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave për sigurimin e zbatimit të RAP dhe Vendimit numër 09/13 (datë 12/02/2015) për organizimin dhe funksionimin e strukturave për zbatimin e dokumenteve strategjike të RAP, të cilat si mekanizëm kryesor të mbikëqyrjes për zbatimin e RAP përcaktojnë Këshillin e Ministrave për Reformën e Administratës Publike që kryesohet nga Ministri i Administratës Publike dhe përbëhet nga Ministri i Financave, Ministri i Integritetit Evropian, Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë dhe një përfaqësues politik nga Zyra e Kryeministrit.

Ndërsa, administrimi dhe koordinimi i monitorimit të zbatimit të RAP në nivel teknik, është i ndarë ndërmjet tri institucioneve:

- Zyra e Kryeministrit është përgjegjëse për reformat lidhur me zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe legjislacionit; që koordinohen nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së.
- Ministria e Administratës Publike përgjegjëse për shërbimin civil, ofrimin e shërbimeve, llogaridhënien dhe organizimin e Administratës Publike; që koordinohen nga Sekretari i Përgjithshëm i MAP-së.
- Ministria e Financave përgjegjëse për reformat lidhur me Menaxhimin e Financave Publike, që koordinohen nga Sekretari i Përgjithshëm i MF-së.

Përgjegjësia për zbatimin dhe raportimin në fushën lidhur me zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe legjislacionit mbetet në kuadër të Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së. Megjithatë, KMRAP është përgjegjës për të siguruar që të gjitha shtyllat e RAP-it krijojnë sisteme koherente për monitorim dhe raportim, që nënkupton se metodologjia e raportimit të përcaktuara nga MAP-i do të vlejnjë për të gjitha shtyllat dhe të gjitha institucionet raportuese përgjatë afateve të njëjta.

Monitorimi dhe raportimi i Strategjisë

Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021 ka edhe planin e vet të veprimit që mbulon periudhën 2017-2019, i cili përbëhet nga aktivitetet, indikatorët, institucionet përgjegjëse dhe koston financiare për zbatim. Plani i veprimit të Strategjisë do të rishikohet në baza dy vjeçare në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në Strategji.

Struktura për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) përbëhet nga indikatorët matës, të cilët janë të vendosur në nivel të objektivave specifike në strategji për vitin 2018 dhe 2021. Një objektivë specifike përmban më shumë se një indikatorë, të cilët kryesisht janë bazuar në indikatorët e SIGMA-së, sipas parimeve që mbulojnë nivelet kryesore horizontale të sistemit të qeverisjes, të cilat përcaktojnë performancën e përgjithshme të administratës publike dhe që në këtë rast kanë të bëjnë me aspektin e zhvillimit dhe koordinimit të politikave. Por, disa nga indikatorët tjerë janë propozuar nga ana e administratës, duke u dakorduar me secilin institucion bartës.


Situata aktuale e prezantuar nën shtyllën e emëruar “Baza (sipas vlerësimit të SIGMA-së)” merret si bazë e vitit 2015 sipas vlerësimit të SIGMA-së për Kosovën. Një pjesë e konsiderueshme e indikatorëve të përdorur në Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021 janë indikatorë kuantitativ sipas kategorizimit të metodologjisë së SIGMA-së. Edhe pse, disa nga objektivat specifike përfshijnë edhe indikatorë kualitativ. Metodologjia e SIGMA-së për matjen e indikatorëve kuantitativ ose kualitativ është si në vijim:

- vlerësimi nga 0 deri në 5, ku nota 0 tregon nivelin më të ulët të progresit, ndërsa nota 5 paraqet nivelin më të lartë të progresit në atë fushë që vlerësohet;
- vlerësimi me përqindje, ku prezantohet niveli i progresit të bazuar me përqindjen e progresit për fushën përkatëse që vlerësohet.

Monitorimi i progresit të zbatimit dhe arritjet e Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021, do t'i komunikohen instancave përkatëse në baza të rregullta dhe sipas nevojës edhe opinionit publik.

Për monitorimin e zbatimit të Strategjisë do të jetë përgjegjës Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS) që përbëhet nga përfaqësues të lartë të nivelit teknik të ZKM, MF, MIE, MAP dhe MZHE.

Koncept Dokumenti për Sistemin e Monitorimit dhe Vlerësimit për Reformën e Administratës Publike 2015-2020 në Kosovë, përcakton elementet kryesore të monitorimit dhe raportimit të RAP, të cilat zhvillohen për Strategjinë e Modernizimit të Administratës Publike, siç janë përgatitja e raporteve tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore; si dhe afatet për përgatitjen e raporteve dhe formatet e raportimit do të vlejnjë po të njëjtat edhe për monitorimin dhe raportimin e Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021. Raportet tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore nga të tre institucionet (ZKM, MAP dhe MF) diskutohen nga Këshilli i Ministrave për Reformën e Administratës Publike (KMRAP), grupit të punës të shtyllës përkatëse në këtë rast GDPS, dhe Bordi i Sekretarëve të Përgjithshëm. Raporti vjetor duhet të diskutohet dhe miratohet nga Qeveria dhe të publikohet më pas.



Monitorimi i progresit do të bazohet në pasaportën e treguesve të vendosur për secilin objektiv specifik. Plani i Veprimit përmban gjithsej 25 tregues për 11 objektivat specifike. Përkufizimi specifik dhe metoda e matjes do të përpunohen më tej në "Pasaportën e Treguesve". Pasaporta e treguesve do të përfshijë gjithashtu një vlerësim të rrezikut për arritjen e objektivit për çdo tregues/arritje. Monitorimi dhe raportimi duhet të koordinohen edhe me monitorimin dhe

raportimin e Strategjisë për Rregullim më të Mirë, meqë të dy strategjitë bëjnë pjesë në kuadër të kornizës së planifikimit strategjik të ZKM-së.

Shqyrtimi afatmesëm i Strategjisë

Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021 do të përcjellet me Planin e Veprimit 2017-2019, i cili do të përditësohet në baza të rregullta vjetore. SPI do të ketë një vlerësim afatmesëm dhe vlerësim përfundimtar. Në këtë mënyrë së bashku me raportin për vitin 2018, ZPS do të ndërmarrë një proces të rishikimit afatmesëm të objektivave dhe treguesve. Vlerësimi afatmesëm dhe përfundimtar i Strategjisë do të fokusohet në këto aspekte: zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit si dhe relevanca e intervenimeve për t'i arritur rezultatet dhe objektivat e synuara.

Procesi i vlerësimeve dhe shqyrtimeve për Sistemin e Planifikimit të Integruar do të ndërlidhet edhe me shqyrtimet dhe vlerësimet në kuadër të Reformës së RAP-it, si dhe vlerësimeve të SIGMA-së dhe vlerësimet e organizatave tjera.

NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve

Plani i Veprimit të Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021 ka një kosto totale të zbatimit prej 2,536,600 Euro.

Burimet e financimit të Strategjisë

Financimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021 parashihet të bëhet nga donatorët, ku tashmë ekziston zotimi nga SIDA dhe Projekti i KE të cilët janë aktiv në ZKM dhe SIGMA. Një pjesë e kostos ka të bëjë me shpenzime të tjera në kuadër të buxhetit ekzistues të Kosovës për periudhën afatmesme të ZKM-së dhe Ministrive të Linjës që do të jenë të përfshira në krijimin e produkteve përkatëse të kësaj Strategjie.

SHTOJCA 1: Plani për Zbatimin e Strategjisë për përmirësimin dhe koordinimin e politikave

Plani i Veprimit për Zbatimin e SPPKP 2017-2019

I. Përmirësimi i mëtutjeshëm i kornizës së planifikimit strategjik						
Objektivi strategjik #1: Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, duke përmirësuar ndërlidhjen e dokumenteve strategjike, përmes koordinimit dhe vendimmarrjes më të mirë						
Objektivi specifik 1.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Ndërlidhja e dokumenteve kryesore strategjike me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe sigurimi i zbatimit të saj	<ul style="list-style-type: none"> Përqindja e ndërlidhjes së Planit Vjetor të Punës së Qeverisë me Udhërrëfyesin për zbatimin e SKZH-së Përqindja e ndërlidhjes ndërmjet Programit për zbatimin e MSA-së me SKZH (përmes Udhërrëfyesit për zbatimin e SKZH-së). 			<ul style="list-style-type: none"> 40% 0 	<ul style="list-style-type: none"> 60% 60% 	<ul style="list-style-type: none"> 95% 90%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Finalizimi i Udhërrëfyesve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) nga Ministritë e linjës.	TM 1 2017	100,000 €	EU Project.	ZKM (ZPS)	ML	Udhërrëfyesi i konsoliduar për zbatim të SKZH-së.
2. Finalizimi i Udhërrëfyesit të konsoliduar të SKZH-së.	TM1 2017	Kosto administrative.	BE + BRK	ZKM (ZPS)	ML	Udhërrëfyesi i miratuar dhe publikuar
3. Sigurimi i ndërlidhjes së Programit të Reformës Ekonomike (PRE) me SKZH.	TM1 2017- TM4 2018	100,000 €		ZKM (ZPS) dhe MF	ML	Masat relevante të SKZH të reflektuara në PRE.

4. Ofrimi i mbështetjes për ministrinë e linjës në hartimin e mëtejshëm të politikave për zbatimin e masave të SKZH-së dhe PRE-së.	TM1 2017 vazhdon deri më TM4 2019	15,789 €	GAP	ZKM (ZPS dhe SKQ)		Mbështetje adekuate/konkrete për ML nga ZPS dhe MIE
5. Sigurimi i reflektimit të masave të SKZH dhe PRE në PVPQ.	TM4 2017 TM4 2018 TM4 2019	Kosto Administrative.	BRK.	ZKM (ZPS dhe SKQ)	MF	Masat e SKZH dhe PRE të reflektuara në PVPQ.
Objektivi specifik 1.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Përmirësimi i planifikimit strategjik të politikave për përmbushjen e detyrimeve të MSA	<ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e masave afatshkurtra të PKZMSA-së të reflektuara në PVPQ (përfshirë Programin Legjislativ të Qeverisë); • Shkalla e zbatimit të Planit të Veprimit të Agjendës për Reforma Evropiane • Shkalla e zbatimit të masave afatshkurtra të PKZMSA-së 			<ul style="list-style-type: none"> • 58% • 0 • 40% 	<ul style="list-style-type: none"> • 80% • 70% • 70% 	<ul style="list-style-type: none"> • 90% • 95% • 90%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Përmirësimi i ndërlidhjes në mes të Programit për Zbatimin e MSA-së dhe Planit Vjetor të Punës së Qeverisë.	TM4 2017	Kosto administrative.	BRK	MIE	ZKM (SKQ), MF	PVPQ reflekton masat kyçe afatshkurtra të PKZMSA-së
2. Përmirësimi i koordinimit në mes të MIE dhe ZKM në procesin e hartimit/rishikimit të rregullt vjetor të PKZMSA dhe PVPQ.	TM1 2017 TM1 2018 TM1 2019	Kosto administrative.	BRK	MIE	ZKM (ZPS, SKQ)	Korniza kohore për rishikimin e PKZMSA-së e harmonizuar me atë për hartimin e PVPQ-së.
3. Ofrimi i udhëzimeve të duhura nga ana e MIE dhe ZKM për institucionet e linjës për	TM1 2017 vazhdon	Kosto administrative.	BRK	MIE	ZKM (ZPS, SKQ)	Masat afatshkurtra të

ndërlidhjen dhe harmonizimin e PKZMSA dhe PVPQ.	TM4 2019					PKZMSA të reflektuara në PVPQ.
4. Sigurimi i ndërlidhjes së ARE me SKZH, PRE, PKZMSA.	TM1 2017 vazhdon TM4 2019	Kosto administrative.	BRK	MIE, ZKM (ZPS)	ZKM (SKQ)	Masat e përfshira në ARE të ndërlidhura me SKZH, PRE dhe PKZMSA.
Objektivi specifik 1.3	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Konsolidimi i Kornizës së Strategjive Sektoriale.	<ul style="list-style-type: none"> •Numri i strategjive të miratuara që dalin nga SKZH në raport me strategjitë e miratuara jashtë fushëveprimit të SKZH-së •Shkalla e strategjive ekzistuese, të zhvilluara para vitit 2016, të cilat janë rishikuar për të konsoliduar kornizën strategjike 			<ul style="list-style-type: none"> • 0% • 0% 	<ul style="list-style-type: none"> • 30 % • 20% 	<ul style="list-style-type: none"> • 90% • 90%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Rishikimi i Udhëzimit Administrativ për hartimin e dokumenteve strategjike.	TM2 2017	100,000 €		ZKM (ZPS)	MF, MIE	Udhëzimi i rishikuar për përgatitjen e dokumenteve strategjike.
2. Përgatitja e manualit për hartimin e dokumenteve strategjike.		Kosto administrative.	BRK			Manuali i hartuar dhe miratuar.
3. Vendosja e hierarkisë së dokumenteve planifikuese në procesin e rishikimit të Rregullores së Punës së Qeverisë	TM3 2017	Kosto administrative.	BRK	ZKM (ZPS)	MF, MIE	Hierarkia e dokumenteve planifikuese e vendosur.
4. Përgatitja e strategjive të reja sektoriale (pilotohen për dy ose tre sektorë), bazuar në	TM1 2018	340,000 €	GAP.	ML	ZKM (ZPS), MF, MIE	Tri strategji të reja sektoriale të

qasjen e SKZH-së dhe Udhëzimin Administrativ të rishikuar për hartimin e strategjive sektoriale.						hartuara në bazë të qasjes së SKZH-së dhe udhëzimeve të reja.
5. Rishikimi i strategjive ekzistuese me qëllim të vendosjes së qasjes sektoriale.	TM1 2019	650,100 €	GAP.	ML	ZKM (ZPS), MF, MIE	Strategji sektoriale të reja/ose rishikuara të hartuara në bazë të qasjes së SKZH-së dhe udhëzimeve të reja.
Objektivi specifik 1.4	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Përmirësimi i Procesit të Koordinimit dhe Vendimmarrjes në nivel qendror dhe në nivelin e ministrive.	<ul style="list-style-type: none"> Numri i ministrive që kanë adaptuar strukturat sipas IPS dhe kalendarin e integruar. Përqindja e zbatueshmërisë së Kalendarit të Planifikimit të Integruar. 			<ul style="list-style-type: none"> 0 0% 	<ul style="list-style-type: none"> 7 50% 	<ul style="list-style-type: none"> 19 80%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Funkcionalizimi i strukturave për planifikim strategjik - Komisionit për Planifikim Strategjik dhe Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik	2017	Kosto Administrative.	BRK.	ZKM (ZPS)	ZKM (SKQ)	Shqyrtimi proceseve kyçe të vendimmarrjes në bazë të kalendarit të integruar.
2. Krijimi i Grupit për Menaxhim Strategjik (GMS) në secilën Ministri të linjës i cili do të kryesohet nga Ministri.	TM4 2017	Kosto Administrative.	BRK.	ML	ZKM (ZPS)	GMS-të të themeluara dhe funksionalizuara në të gjitha ML.
3. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Kalendarit të Planifikimit të Integruar	TM4 2017	Kosto Administrative.	BRK.	ML	ZKM (ZPS, SKQ)	Kalendari i Planifikimit të Integruar është

						hartuar nga GDPS dhe miratuar nga KPS.
II. Ndërlidhje më e mirë ndërmjet dokumenteve strategjike dhe burimeve financiare						
Objektivi Strategjik #2: Ndërlidhja më e mirë e kornizës për planifikim strategjik me planifikimin e resurseve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përballueshmërinë financiare dhe zbatimin e planeve strategjike.						
Objektivi specifik 2.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Përmirësimi i orientimit strategjik të KASH-it/buxhetit.	<ul style="list-style-type: none"> Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të.¹⁸ Përqindja e mbulimit të veprimeve SKZH në KASH (përmes zbatimit të Udhërrëfyesit të SKZH). Raporti ndërmjet fondeve të përgjithshme të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe financimit të përgjithshëm të identifikuar për sektorët përkatës në KASH Kërkesat e kalendarit të Sistemit për Planifikim të Integruar janë përmbushur për planifikimin e KASH-it dhe buxhetit 			<ul style="list-style-type: none"> 7.5% 40%¹⁹ 20% Jo. 	<ul style="list-style-type: none"> 5% 60% 40% Po. 	<ul style="list-style-type: none"> 3.5% 90% 75% Po.
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti

¹⁸ Indikator i përcaktuar në Strategjinë për Reformën e MFP-së

¹⁹ Ky është vlerësim preliminar bazuar në numrin e aktiviteteve dhe masave të SKZH-së të cilat janë në proces të zbatimit, një vlerësim më i plotë do të bëhet në momentin e finalizimit të Udhërrëfyesit për Zbatimin e SKZH-së

1. Hartimi i Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë për KASH bazuar në prioritetet e zhvillimit kombëtare dhe procesit të integritimeve evropiane	TM4 2017	Kosto Administrative.	BRK.	ZKM (ZPS)	MF	DPPA përfshin prioritetet nga SKZH, ARE, PKZMSA, PRE dhe dokumentet tjera strategjike sektoriale.
2. Shqyrtimi i Deklaratës së Prioriteteve, dokumentit të KASH dhe Buxhetit Vjetor nga strukturat përkatëse (Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS) dhe Komisioni për Planifikim Strategjik ²⁰).	TM 2 2017 deri TM4 2019	Kosto Administrative.	BRK.	ZKM,	MF, MIE, dhe anëtarët e KPS	Deklarata e Prioriteteve, KASH dhe Buxheti Vjetor i shqyrtuar nga GDPS dhe KPS.
3. Reflektimi i kostove të strategjive sektoriale në KASH sipas metodologjisë së paraparë në UA 03/2015	TM4 2017	Kosto Administrative.	BRK	MF, ML	ZKM (ZPS)	KASH reflekton koston e strategjive sektoriale.
4. Kostimi i SKZH dhe adresimi i nevojave për financim nga KASH.	TM4 2017	Kosto Administrative.	BRK	ML	ZPS, MF	Reflektimi i koston të SKZH-së për tri vitet e para të KASH-it.
5. Organizatat Buxhetore në kuadër të kufijve buxhetorë të paraparë në KASH paraqesin aktivitetet e tyre që derivojnë nga SKZH.	TM1 2017 deri TM4 2019	Kosto Administrative.	BRK	OB, MF	ZKM (ZPS)	Propozimet e masave nga SKZH për përfshirje në KASH janë brenda kufijve buxhetorë të OB.
Objektivi specifik 2.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021

²⁰ Ky aktivitet figuron po ashtu edhe në Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike Objektivi (4) ku flitet për avancimin e mëtejshëm të rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet ardhshme.

Përmirësimi i buxhetimit afatmesëm dhe afatshkurtër, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të MSA-së.	<ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e prioriteteve të Deklaratës së prioriteteve afatmesme të integrimit evropian për financim nga KASH të reflektuar në KASH dhe në shpërndarjen e buxhetit sipas tij; • Përqindja e masave afatshkurtra të PZKMSA-së të kostuara dhe mbuluara me buxhet vjetor përgjatë tërë vitit. 	<ul style="list-style-type: none"> • 0²¹% • 45% 	<ul style="list-style-type: none"> • 80% • 80% 	<ul style="list-style-type: none"> • 100% • 100% 		
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Hartimi i Deklaratës së prioriteteve afatmesme të integrimit evropian për financim nga KASH dhe shqyrtimi i saj nga strukturat koordinuese për planifikim strategjik. ²²	TM4 2017	Kosto administrative.	BRK	MIE, MF	ZKM (ZPS) Institucionet e linjës	Deklarata e prioriteteve afatmesme të integrimit evropian për financim nga KASH e hartuar dhe rishikuar çdo fund vit (gjatë rishikimit të PKZMSA-së) Strukturat koordinuese për planifikim strategjik shqyrtojnë Deklaratën, me

²¹ Duhet të bëhet vlerësim i mbulimit të masave afatshkurtra të PKZMSA-së në KASH

²² Kjo reflektohet në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë siç është e përcaktuar në aktivitetin 2.1.1

						qëllim të sigurimit të reflektimit të prioriteteve të saj në kuadër të KASH-it
2. Kostimi i duhur i masave afatshkurtra të PZKMSA-së dhe sigurimi i mbulimit të tyre me buxhet vjetor përgjatë tërë vitit.	Vazhdimisht, duke filluar nga TM1 2017	Kosto administrative.	BRK	MIE, MF	Institucionet e linjës	Zbrazësitë buxhetore të hasura në zbatimin e masave afatshkurtra të PZKMSA-së theksohen në raportet e rregullta tremujore, MIE dhe MF u ofrojnë institucioneve të linjës udhëzime të duhura për kostimin dhe buxhetimin e PZKMSA-së
Objektivi specifik 2.3	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Menaxhimi efektiv i ndihmës së jashtme	<ul style="list-style-type: none"> Programi për Asistencën Zhvillimore i miratuar dhe i ndërlidhur me KASH i shprehur në përqindjen e mbulimit të prioriteteve. Përqindja e ndërlidhjes së Projekteve nga Lista 			<ul style="list-style-type: none"> 0 0% 	<ul style="list-style-type: none"> 50 % 70% 	<ul style="list-style-type: none"> 70% 90%

Aktiviteti	Prioritare e Projekteve prioritete e SKZH-së ²³			Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit			
1. Prezantimi i procedurave të reja për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve të financuar nga donatorët e AJ-së bazuar në arkitekturën e SIP dhe duke lejuar "tri faza të procesit të shqyrtimit" (MIE (+) - GDPS - KPS)	TM4 2017	80,750 €	GAP	MIE	ZKM (ZPS), MF	Metodologjia, standardet dhe formatet për të udhëzuar ministrinë e linjës në përgatitjen e projekteve të AJ-së dhe procesin e dorëzimit.
2. Përgatitja e raportit vjetor për projektet të financuara nga donatorët e AJ-së (duke theksuar rezultatet e arritura kundrejt atyre të pritshme dhe kontributet e asistencës së jashtme).	TM4 2017 vazhdon TM4 2019	Kosto Administrative.	BRK.	MIE	ZKM MF	Raporti vjetor për përfitimet nga asistenca e jashtme.
3. Fuqizimi i ndërlidhjes ndërmjet projekteve të investimeve publike me prioritetet e SKZH-së dhe strategjive sektoriale, përmes funksionalizimit të strukturave për planifikim të integruar.	TM4 2017	Kosto Administrative.	BRK	ZKM, MF	ZKM, MIE	Projektet e investimeve publike të ndërlidhura me prioritetet e SKZH dhe strategjive sektoriale.
4. Bashkëpunimi me donatorë për mbulimin e zbrazëtirës buxhetore për financimin e SKZH nga KASH.	TM1 2017 vazhdon TM4 2019	Kosto Administrative.	BRK	ZKM, MF	ML	AJ e ndërlidhur me zbrazëtirë buxhetore të financimit të masave të SKZH
III. Integrimi i praktikave dhe proceseve të monitorimit						
Objektivi Strategjik #3: Integrimi i plotë i praktikave dhe proceseve të monitorimit për të siguruar rezultate më të mira të zbatimit dhe						

²³ Kjo duhet të përfshijë Programin për Investime Publike dhe Listën e Projekteve Prioritare, të cilat janë të reflektuara në kuadër të klauzolës së investimeve

Ilogaridhënies për përmbushjen e objektivave të vendosura të Qeverisë.						
Objektivi specifik 3.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Përmirësimi i monitorimit të strategjive sektoriale duke përfshirë vlerësimin periodik të tyre.	<ul style="list-style-type: none"> Përqindja e strategjive sektoriale që kanë raporte vjetore të hartuara dhe publikuara Raportet vjetore të strategjive të zhvilluara sipas Udhëzimit Administrativ të rishikuar, po ashtu përfshijnë informata rreth arritjeve kundrejt objektivave (produktet/rezultatet) 			<ul style="list-style-type: none"> 0% 0% 	<ul style="list-style-type: none"> 40% 80% 	<ul style="list-style-type: none"> 90% 100%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Hartimi i metodologjisë dhe manualit për vlerësimin e strategjive sektoriale në kuadër të rishikimit të Udhëzimit Administrativ për hartimin e dokumenteve strategjike.	TM4 2017	Kosto Administrative.	BRK.	ZKM (ZPS)	ZPS (SKQ)	Metodologjia dhe manuali për vlerësimin e strategjive sektoriale të hartuara.
2. Përgatitja dhe publikimi i raporteve vjetore për zbatimin e strategjive sektoriale.	TM4 2017 vazhdon TM4 2019	Kosto Administrative.	BRK.	ZKM (ZPS)	ZKM (SKQ), ML	Raportet të publikuara vjetore për zbatimin e strategjive sektoriale.
3. Vlerësimi i strategjive sektoriale në periudha afatmesme.	TM4 2017 vazhdon TM4 2019	Kosto Administrative.	BRK.	ML	ZKM (ZPS)	Raportet e strategjive sektoriale të vlerësuara në periudha afatmesme.
Objektivi specifik 3.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Fuqizimi i rolit të sistemit të monitorimit të PVPQ-së si mekanizëm për informim të politikë-bërësve dhe rritjes së llogaridhënies të ML.	<ul style="list-style-type: none"> Çështjet e pakryera në zbatimin vjetor nga zotimet e planifikuara në dokumentin(et) e planifikimit në nivelin qendror. (përqindja e zotimeve të përgjithshme të PVPQ-së të bartura në vitin vijues). 			<ul style="list-style-type: none"> 26 % 	<ul style="list-style-type: none"> 15 % 	<ul style="list-style-type: none"> 10%

	<ul style="list-style-type: none"> Indikatorët e performancës janë zhvilluar dhe përfshirë në PVPQ. Çështjet e pakryera në zbatimin vjetor nga zotimet e planifikuara në PKZMSA (përqindja e zotimeve të përgjithshme të PKZMSA-së të bartura në vitin vijues). 			<ul style="list-style-type: none"> Jo. 0²⁴ 	<ul style="list-style-type: none"> Po. 25% 	<ul style="list-style-type: none"> Po. 10%.
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Zhvillimi i një strukture dhe metodologjie të unifikuar të monitorimit dhe raportimit të arritjes së PVPQ-së, duke synuar integrimin e saj me dokumente planifikuese afatmesme (SKZH, ERA, PKZMSA, PRE) dhe strategjitë sektoriale.	TM4 2018	30,000 €	GAP	ZKM (SKQ)	ZKM (ZPS), MIE	Struktura dhe metodologjia për monitorim të PVPQ-së të ndërlidhur me dokumente planifikuese afatmesme dhe strategjitë sektoriale.
2. Zhvillimi i modalitetit për monitorimin e SKZH-së dhe PRE-së si pjesë e PVPQ-së.	TM 3 2017	83,750 €	GAP	ZKM (ZPS, SKQ)	ML	Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të SKZH-së
3. Vendosja e modaliteteve, roleve dhe përgjegjësi për monitorimin e implementimit të udhërrëfyesit të SKZH dhe monitorimit ekzistues, në kuadër të PVPQ.	TM4 2017	30,000 €	GAP	ZKM (ZPS dhe SKQ)	ML	Raporti për zbatimin e udhërrëfyesit të SKZH i integruar në Raportin e PVPQ.
4. Mbikëqyrja dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të PKZMSA-së, përfshirë (sipas nevojës) përmes strukturave koordinuese kombëtare për integrim evropian dhe atyre të Stabilizim-	TM1 2017 (vazhdimisht çdo vit, në baza tremujore)	Kosto administrative	BRK	MIE	Institucio net e linjës	Udhëzime dhe këshillime për ML në zbatimin e

²⁴ Vlera bazë është marr për vitin 2015, për shkak se viti 2016 është viti i parë i zbatimit të PKZMSA-së dhe nuk mund të vlerësohet se sa janë bartur në vitin vijues

Asociimit						PKZMSA-së. Raportet e rregullta tremujore mbi zbatimin e PKZMSA-së;
5. Mbikëqyrja dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të Planit të Veprimit të ARE, përfshirë (sipas nevojës) përmes strukturave koordinuese kombëtare për integrim evropian dhe atyre të Stabilizim-Asociimit	TM1 2017 (vazhdimisht çdo vit, në baza tremujore)	Kosto administrative.	BRK.	MIE	Institucionet e linjës	Raportet e rregullta gjashtëmujore mbi zbatimin e PV-ARE diskutohen nga Kabineti Qeveritar, Strukturat koordinuese për integrim evropian, dhe në strukturat e Stabilizim-Asociimit dhe adresohen nga institucionet zbatuese
IV. Ngritja e kapaciteteve për planifikim dhe koordinim të politikave						
Objektivi Strategjik #4: Ngritja e kapaciteteve të administratës për planifikim dhe koordinim të politikave për arritje të rezultateve më të						

mira të planifikimit si dhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave koordinues në aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit.						
Objektivi specifik 4.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Plotësimi i kapaciteteve të nevojshme për planifikimin dhe koordinimin e politikave	•Nivelet e stafit të departamenteve brenda ZKM-së dhe QQ (përgjegjës për zhvillimin, koordinimin dhe analizimin e politikave), krahasuar me detyrat e sektorëve të ndryshëm			/	/	/
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Vlerësimi i nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe rritje të stafit në departamentet brenda ZKM-së dhe QQ (përgjegjës për zhvillimin, koordinimin dhe analizimin e politikave), krahasuar me detyrat e sektorëve të ndryshëm.	TM4 2018	12,000 €	Mbështetje nga Projekti i SIDA	ZKM(ZPS, SKQ)	SIDA Project	Raport për vlerësimin e nevojave në ZKM dhe QQ për ngritje të kapaciteteve të stafit aktual, si dhe është bërë rishikimi për nevojën e plotësimit me staf të nevojshëm.
Objektivi specifik 4.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2018	Caku 2021
Zhvillimi i kapaciteteve për planifikimin dhe koordinimin e politikave.	<ul style="list-style-type: none"> Numri i trajnerëve të përgatitur për planifikimin dhe zbatimin e MSA-së dhe për zhvillim të politikave Kapacitetet për zhvillim të politikave në kuadër të institucioneve të qendrës së qeverisë dhe të gjitha ministrisë e linjës janë ngritur përmes programeve trajnuese dhe programeve për trajner. 			0 /	15 25%	15 75%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti

1. Ofrimi i trajnimeve/programeve të trajnimit për trajner për planifikimin dhe zbatimin e MSA-së dhe për zhvillim të politikave.	TM4 2017	20,000	GAP	MIE	ZKM (ZPS), IKAP	Numri i zyrtarëve të certifikuar për trajner.
2. Organizimi dhe ofrimi i trajnimeve për zyrtarë për proceset e sistemit të planifikimit të integruar dhe fuqizimin e koordinimit dhe strukturave vendimmarrëse	TM1 2018 vazhdon TM4 2019	20,000	GAP	ZKM(ZPS)	IKAP, MIE, MF	Plan-programi i trajnimit; numri i zyrtarëve të trajnuar.
3. Organizimi dhe ofrimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të administratës për menaxhimin e ndihmës së jashtme, si pjesë e rregullt e programeve të ofruara nga IKAP.	TM4 2017 vazhdon TM4 2019	20,000	GAP	MIE	IKAP, MF	Plan-programi i trajnimit, dhe numri i zyrtarëve të trajnuar.
4. Organizimi dhe ofrimi i trajnimeve për zyrtarë për monitorim, raportim dhe vlerësim të integruar të politikave.	TM4 2018	20,000	GAP	ZKM (SKQ)	ZKM (ZPS), IKAP	Plan-programi i trajnimit; numri i zyrtarëve të trajnuar.